



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



RAPORTI VJETOR PËR PUNËN

E

KOMISIONIT SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

për
vitin 2020



Shkup, mars 2021

RAPORTI VJETOR PËR PUNËN E KSHPK PËR VITIN 2020

Përmbajtja

1.	HYRJE	1
2.	STATUSI, UDHËHEQËSIA, KOMPETENCAT DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE	3
2.1.	Korniza ligjore	3
2.2.	Mandati dhe statusi i kryetarit dhe anëtarëve	4
2.3.	Sekretariati i KSHPK	5
3.	AKTIVITETE TË REALIZUARA QË BUROJNË NGA KOMPETENCAT LIGJORE TË KSHPK	8
3.1.	<i>Strategjia Nationale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave</i>	8
3.2.	<i>Procedimi në raste dyshimi për korrupsion</i>	13
3.3.	<i>Procedimi në raste të konfliktit të interesave</i>	22
3.4.	<i>Mbikëqyrja e ligjshmërisë së financimit të fushatave zgjedhore</i>	25
3.5.	<i>Evidentimi dhe mbikëqyrja e pasurisë</i>	29
3.6.	<i>Kontrolli i të dhënave nga deklaratat e pasurisë dhe interesave</i>	30
3.7.	<i>Regjistri i personave të zgjedhur dhe të emëruar</i>	31
3.8.	<i>Zhvillimi i procedurave kundërvajtëse</i>	32
3.9.	<i>Kontrolli i ligjeve dhe akteve nënligjore antikorrupsion</i>	33
3.10.	<i>Përvoja nga zbatimi i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave</i>	34
3.11.	<i>Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve – LMS</i>	38
3.12.	Shqyrtimi i kërkesave për qasje në informata me karakter publik	43
3.13.	<i>Zbatimi i rekomandimeve të GRECO-s nën kompetenca të KSHPK</i>	44
4.	VLERËSIMI I GJENDJES SË KORRUPSIONIT DHE LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT NË VEND	45
5.	AKTIVITETE PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË PUNËS	47
5.1.	RREGULLORE E PUNËS E KSHPK	47
5.2.	PLANI STRATEGJIK PËR PERIUDHËN 2021-2023	47
5.3.	STRATEGJIA PËR PROMOVIMIN E SISTEMIT PËR MBROJTJE TË SINJALIZUESVE	47
5.4.	KRITERE PËR RANGIM TË LËNDËVE TË CILËT I SHQYRTON KSHPK	48
5.5.	TRANSPARENCA NË PUNËN E KSHPK DHE INFORMIMI I OPINIONIT PUBLIK	48
6.	BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TJERA DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	49
6.1.	BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE	49
6.2.	BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE	52
7.	BUXHETI, BILANCI VJETOR DHE FINANCIMI	55
8.	PËRFUNDIMET	58
9.	REKOMANDIME	59
10.	SHTOJCA	
	OR! BOOKMARK NOT DEFINED.	ERR

Përmbledhje

Ky raport pasqyron punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (më tutje në tekst: KShPK) gjatë vitit 2020.

Ligji i ri për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, i cili u miratua në janar të vitit 2019, rriti dhe forcoi kompetencat e KSHPK dhe siguroi mekanizma më efektive për veprim, që rriti edhe pritshmëritë e opinionit publik për parandalim dhe luftë më efektive të korrupsionit.

Megjithëse viti 2020 do të mbahet mend si një vit i luftës për mbrojtjen e shëndetit publik në nivel global për shkak të efekteve të pandemisë së *Kovid-19*, në Republikën e Maqedonisë së Veriut viti 2020 do të mbahet mend si një vit me një periudhë katërmujore të “gjendjes së jashtëzakonshme”, një periudhë tetëmuajore të “Qeverisë Teknike”, vit i “zgjedhjeve të parakohshme parlamentare-2020” dhe dhjetë muajve të funksionimit në kushte të *Kovid-19*.

Ndërgjegjësimi dhe guximi i shtuar i qytetarëve për të raportuar paligjshmëritë dhe parregullsitë në punën e zyrtarëve, kontribuan që KSHPK gjatë vitit 2020 të pranojë 550 parashtresa nga qytetarë për dyshime të sjelljeve korruptive, keqpërdorim të detyrës publike dhe konflikt interesi, që rezultoi me hapjen e 102 rasteve me vetiniciativë të KShPK.

- Në sferën e korrupsionit u morën vendime për 378 lëndë;
- Në sferën e konfliktit të interesave u morën vendime për 157 lëndë;
- Për mosrespektim të ndalesave gjatë procesit zgjedhor u morën vendime për të gjitha 33 parashtresat;
- Në sferën e kontrollit të të dhënave të listave anketuese u morën vendime për 38 parashtresa.

Duke vepruar në kuadër të kompetencave tjera, KShPK:

- Rishikoi Strategjinë Nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave për shkak të mosmiratimit të saj nga përbërja e mëparshme parlamentare;
- Kreu kontrollin antikorrupsion të shtatë ligjeve;
- Filloi zbatimin e disa projekteve të mbështetura nga organizata vendase dhe ndërkombëtare;
- Miratoi akte të reja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e KShPK

Në kushte të një pandemie, e në funksion të marrjes së vendimeve brenda kompetencës së tij, KSHPK mundësoi mbajtjen e seancave *online*, në të cilat mediave u lejohej të marrin pjesë.

Problemi i hapësirës joadekuate, numri i pamjaftueshëm i të punësuarve dhe mjeteve të shkurtuara financiare për prokurimin e softuerit të nevojshëm, edhe gjatë vitit 2020 ishin faktorë kufizues që ndikuan në mënyrë të konsiderueshme në funksionimin efikas të KShPK.

1. Hyrje

Në drejtim të përmbushjes së kompetencës nga neni 19 i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (më tutje në tekst LPKKI), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (më tutje në tekst: KShPK), përgatiti këtë raport për punën e tij gjatë vitit 2020. Raporti i paraqitet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe i dërgohet Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe mjeteve për informim publik.

Viti 2020 do të mbahet mend si vit i pandemisë *Covid-19* dhe vit i mbrojtjes së shëndetit publik, si një qëllim prioritar në të gjithë botën. Për të njëjtin qëllim, Qeveria e RMV përcaktoi kushtet e veçanta të punës dhe masat kufizuese për punë dhe lëvizje, të cilat dukshëm penguan funksionimin e rregullt të të gjitha subjekteve, si ato të sektorit privat, ashtu edhe ato të sektorit publik, përfshi këtu edhe KShPK.

Pavarësisht numrit të vogël të të punësuarve, zbatimi i masave për mbrojtjen kundër virusit *Corona* për punë në ndërrime, mungesat për shkak të infeksionit viral ose izolimit të karantinës, ndikuan dukshëm në dinamikën e punës së KShPK dhe zgjatjen e procedurave të lëndëve dhe projekteve të filluara. Të ballafaquar me pamundësinë e mbajtjes së seancave publike dhe vendimmarrjes, KShPK ndryshoi Rregulloren e Punës së KShPK, që mundësoi mbajtjen *online* të seancave dhe kolegjiuemeve, si dhe punën nga shtëpia të të punësuarve.

Me përkushtim të madh dhe angazhim të numrit të vogël të të punësuarve, edhe në kushte të krizës shëndetësore, KShPK arriti t'u përgjigjet kompetencave që ka, duke mbajtur rregullisht takime, duke shqyrtuar rregullisht lëndët dhe parashtresat e paraqitura, duke mbajtur takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqatave, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet ndërkombëtare, me qëllim të promovimit dhe zbatimit të masave dhe aktiviteteve që synojnë forcimin e luftës kundër korrupsionit.

Gjatë vitit 2020, u hartua dhe miratua Rregullorja për organizimin e brendshëm të Sekretariatit të KShPK dhe Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e KShPK, me çka u mundësua organizimi i të punësuarve sipas kompetencave të zgjeruara ligjore, por edhe u krijua hapësirë për rritjen e numrit të të punësuarve. Megjithatë, gjatë vitit 2020 KShPK nuk realizoi punësime të reja, kryesisht për shkak të zvogëlimit të mjeteve buxhetore (siç edhe ndodhi në të gjitha institucionet e tjera të sektorit publik) dhe nevojës për rialokimin e tyre në drejtim të ballafaqimit me pasojat e krizës nga *Kovid-19*.

Problemi me kushtet e papërshtatshme të hapësirave gjatë vitit 2020 ishte arsyeja pse pajisjet kompjuterike të siguruar përmes IPA-fondeve të Bashkimit Evropian në 2018 nuk janë ende funksionale. Sidoqoftë, me përpjekje maksimale, u siguruan fonde dhe u publikua një shpallje publike për prokurimin e një zgjidhjeje softuerike për dërgimin elektronik të Deklaratave të pasurisë, i cila u anulua në shtator të vitit 2020 për shkak të lëshimeve të mëdha dhe mangësive në specifikimin teknik.

Këto dhe aktivitete të tjera që u realizuan gjatë vitit 2020, paraqesin rrugën përgjatë së cilës KShPK arrin të realizojë

Misionin që ka: "KShPK zbaton dhe inkurajon zbatimin e qëndrueshëm të ligjeve, forcimin normativ dhe institucional, krijon politika anti-korrupsion, imponon masa parandaluese dhe shtypëse që ndikojnë në parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave gjatë ushtrimit

të pushtetit dhe kompetencave publike, detyrës zyrtare dhe politikës, promovon sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë dhe zhvillon një kulturë ligjore”, në mënyrë që të përmbushë

Vizionin e tij: “për të krijuar një sistem funksional dhe efikas për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesave”

2. Statusi, udhëheqësia, kompetencat dhe struktura organizative

2.1. Korniza ligjore

Nga janari i vitit 2019, në fuqi është Ligji i ri për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (në tekstin e mëtejme: LPKKI), i cili ka rritur kompetencat e KShPK, duke rritur kështu edhe peshën e tij institucionale.

Konform LPKKI, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është subjekt i pavarur që kryen veprimtari të përcaktuara me ligj si person juridik. Neni 17 i LPKKI përcakton 29 kompetenca që zakonisht mund të ndahen në gjashtë segmente të funksionimit, siç paraqitet në Tabelën 1.

Tabela 1: Kompetencat e KSHPK

Funksionet e KShPK	Kompetencat nga neni 17
1. Zhvillimi i politikave antikorruptive dhe përmirësimi i klimës antikorruption	<ul style="list-style-type: none"> ○ Miraton strategjinë kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, me një plan veprimi për zbatimin e tij (pika 1); ○ Kryen kontrollin antikorruption të ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve tjera të përgjithshme, në përputhje me Metodologjinë e miratuar nga vetë KSHPK (pika 2); ○ Bashkëpunon me shoqatat, fondacionet, institucionet shkencore dhe sektorin privat, në lidhje me parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave (pika 16); ○ Përgatit analiza për rreziqet e korrupsionit në sektorë të ndryshëm (pika 17); ○ Realizon aktivitete që synojnë forcimin e integritetit personal dhe institucional (pika 18); ○ Realizon sondazheve të opinionit publik, për të vlerësuar funksionimin e tij dhe gjendjen e korrupsionit (pika 23); ○ Informon në mënyrë të rregullt opinionin publik për punën e tij (pika 28); ○ Realizon aktivitete në fushën e arsimit dhe ngritjes së vetëdijes për korrupsionin dhe konfliktin e interesave (pika 19).
2. Mbikëqyrja dhe kontrolli i vazhdueshëm i pasurisë dhe interesave të personave të zgjedhur dhe të emëruar, financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, si dhe mbajtjen e regjistrave përkatës	<ul style="list-style-type: none"> ○ Monitoron ligjshmërinë e financimit të fushatave zgjedhore (pika 7); ○ Monitoron ligjshmërinë e financimit të partive politike (pika 6); ○ Regjistron dhe monitoron pasurinë dhe interesat e personave të përfshirë me këtë ligj (pika 10); ○ Evidenton deklaratat e pasurisë dhe interesave (pika 11); ○ Kontrollon të dhënat nga deklaratat e pasurisë dhe interesave (pika 12); ○ Bashkëpunon me organet shtetërore në sigurimin e informatave të nevojshme (pika 13); ○ Mban një regjistër të personave të zgjedhur dhe të emëruar (pika 20);

RAPORTI VJETOR PËR PUNËN E KSHPK PËR VITIN 2020

	<ul style="list-style-type: none"> ○ Përgatit katalogun e dhuratave bazuar në të dhënat e siguruara, në përputhje me nenin 58 të LPKKI dhe publikon katalogun në faqen e tij të internetit (pika 22).
3. Ngritja e iniciativave para organeve tjera kompetente, përcaktimi i situatave të konfliktit të interesave, procedurat e kundërvajtjes	<ul style="list-style-type: none"> ○ Shqyrton parashtresat nga personat fizikë dhe juridikë mbi dyshimet për korrupsion dhe konflikt interesi (pika 3); ○ Ngre iniciativë para autoriteteve kompetente për të filluar një procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së zyrtarëve (pika 4); ○ Ngre procedurë për ndjekje penale në çështjet që trajton (pika 5); ○ Ngre iniciativë bazuar në raportet e Entit Shtetëror për revizion (pika 8); ○ Shqyrton procedurat për kundërvajtje, për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 100 - 113 të LPKKI (neni 114, paragrafi 2)
4. Bashkëpunimi me organe shtetërore, organe dhe organizata vendase dhe ndërkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> ○ Bashkëpunon me organet shtetërore në sigurimin e informatave (pika 13); ○ Bashkëpunon me organet shtetërore të vendeve tjera, si dhe me organizatat ndërkombëtare në fushën e parandalimit të korrupsionit (pika 14); ○ Shkëmben informata me organet kompetente të shteteve tjera dhe organizatave ndërkombëtare, bazuar në detyrimet e ndërmarrja nga marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën (pika 15); ○ Bashkëpunon me shoqatat, fondacionet, institucionet shkencore dhe sektorin privat në lidhje me parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (pika 16).
5. Edukimi dhe sensibilizimi për korrupsionin dhe konfliktin e interesave	<ul style="list-style-type: none"> ○ Realizon aktivitete në fushën e arsimit dhe ngritjen e vetëdijes për korrupsionin dhe konfliktin e interesave (pika 19).
6. Funkionimi i vazhdueshëm i Komisionit	<ul style="list-style-type: none"> ○ Miraton programin vjetor të punës (pika 24); ○ Miraton një kod etik për anëtarët dhe Sekretariatit; ○ Miraton Rregulloren e Punës (pika 26); ○ Miraton aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariat (pika 27).

KSHPK-së i janë dhënë kompetenca me ligje tjera të tilla, si Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve (Gazeta Zyrtare nr.196/2015 dhe 35/2018), Ligji për lobim (Gazeta Zyrtare nr.106/2008 dhe 135/2011) dhe Kodi Zgjedhor (Gazeta Zyrtare nr.40/2006...42/20).

2.2. Mandati dhe statusi i kryetarit dhe anëtarëve

Komisioni shtetëror përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë, të cilët kanë statusin e personave të emëruar. Kryetari dhe anëtarët e KSHPK zgjidhen me konkurs publik, të cilin e shpall Kuvendi në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me LPKKI, që siguron transparencë dhe pjesëmarrje të publikut në zgjedhjen e anëtarëve.

Kryetari dhe anëtarët e KSHPK emërohen nga Kuvendi i RMV për një periudhë pesëvjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje. Nga radhët e anëtarëve të KSHPK, me shumicë votash nga përbërja e përgjithshme e anëtarëve, zgjidhet zëvendëskryetari mbi parimin e rotacionit çdo gjashtë muaj.

Kryetari dhe anëtarët e KSHPK kryejnë funksionin e tyre profesionalisht dhe me orar të plotë. Kuvendi i RMV shkarkon kryetarin dhe anëtarin e KSHPK me propozim të Komisionit për Zgjedhje dhe Emërime të Kuvendit, në rast se plotësohet kushti për shkarkim, siç parashihet me LPKKI.

Përbërja e tanishme e Komisionit u zgjodh më 8 shkurt të vitit 2019, me Vendim për emërim të kryetarit dhe anëtarëve të KSHPK nga Kuvendi i RMV.

2.3. Sekretariati i KSHPK

Sekretariati i KSHPK është një shërbim ekspert që kryen punët administrative nën kompetenca të Komisionit.

Personeli i Sekretariatit do të ketë statusin e personelit administrativ, të kryesuar nga një Sekretar i Përgjithshëm të cilin e zgjedh KSHPK me shumicë votash.

Për nevojat e KShPK, gjatë vitit 2019 u përgatit një analizë funksionale në mënyrë që të paraqitet gjendja aktuale e kapaciteteve në dispozicion të KSHPK (hapësinore, materiale, teknike, të punësuarve), ndikimi i tyre në funksionimin e KShPK, por edhe për të kryer vlerësimin e strukturës së duhur organizative dhe burimeve njerëzore për të përmbushur kompetencat ligjore. Bazuar në Analizën Funksionale të përgatitur në dhjetor të vitit 2019, u hartuan aktet e reja: Rregullorja për organizimin e brendshëm të Sekretariatit të KSHPK dhe Rregullorja për sistematizimin e punëve në Sekretariatit të KShPK, të cilat u miratuan nga Komisioni në një seancë të korrik të vitit 2020. Pas marrjes së pëlqimit të MSHIA, në gusht të vitit 2020 KSHPK filloi me zbatimin e akteve të reja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariat. Ato janë në dispozicion të publikut përmes faqes së internetit të KShPK.

Me aktet e reja për organizim të brendshëm dhe sistematizim, të punësuarit në Sekretariat janë të organizuar në këto forma organizative:

1. Sekretar Gjeneral;
2. Këshilltar Shtetëror për politika parandaluese antikorrupsion;
3. Këshilltar Shtetëror për zbatimin e masave dhe aktiviteteve për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave
4. SEKTORI PËR PLANIFIKIM STRATEGJIK DHE INTEGRITET, me dy departamente:
 - Departamenti për planifikim strategjik, bashkëpunim, projekte, analitikë dhe edukim;
 - Departamenti për kontroll të legjislationit antikorrupsion.
5. SEKTORI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT, me këto departamente:
 - Departamenti për parandalimin e korrupsionit;
 - Departamenti për mbikëqyrje të financimit të partive politike, fushatave zgjedhore dhe korrupsionit në prokurimet publike.
6. SEKTORI PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE, MBIKËQYRJE TË PASURISË, INTERESAVE DHE LOBIMIT, me këto departamente:
 - Departamenti për parandalimin e konfliktit të interesave dhe lobimit;
 - Departamenti për mbikëqyrjen e pasurisë dhe interesave.
7. SEKTORI PËR INFORMATIKË, PUNË TË PËRGJITHSHME, SEANCA DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN, me këto departamente:

RAPORTI VJETOR PËR PUNËN E KSHPK PËR VITIN 2020

- Departamenti për informatikë dhe punë të përgjithshme;
- Departamenti për seanca dhe marrëdhënie me publikun.

Si njësi të pavarura organizative që për punën e tyre i përgjigjen në mënyrë të drejtëpërdrejtë Sekretarit të përgjithshëm, janë formuar:

- Departamenti për financa dhe
- Departamenti për burime njerëzore.

Tabela 2 tregon strukturën e burimeve njerëzore të KSHPK lidhur me numrin e planifikuar të të punësuarve dhe gjendjen aktuale të plotësimit sipas vendeve të punës, nivelit të arsimit, gjinisë dhe përkatësisë etnike.

Tabela 2: Struktura e burimeve njerëzore në KSHPK

Lloji/ i nëpunësve administrativë	Të planifikuar	Të punësuar	Arsim të lartë	Arsim të mesëm	Meshkuj	Femra	Maqedonë	Shqiptarë	Vlleh	Serbë	Tjerë
Sekretar Gjeneral	1	1	1			1	1				
Këshilltarë shtetërorë	2	0									
Udhëheqës administrativë	15	3	3			3	3				
Nëpunës ekspertë administrativë	39	18	18		7	11	13	2	1	1	1
Nëpunës ndihmës administrativë	3	1		1		1	1				
Gjithsej	60	23	22	1	7	16	18	2	1	1	1

Nga personeli administrativ me arsim të lartë, 10 nga të punësuarit kanë kualifikim master dhe një është doktor i shkencave.

Në tetor të vitit 2020, një zyrtari administrativ nga Sekretariati i KSHPK i përfundoi marrëveshja e tij e punës, kështu që numri i përgjithshëm i stafit administrativ të punësuar në Sekretariatit e KSHPK në vitin 2020 është 23 persona nga 60 të planifikuar, që paraqet plotësim prej 38% të vendeve të punës të parapara me aktin e ri për sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e KSHPK.

Edhe gjatë vitit 2020, si dhe në vitin 2019, gjendja me numrin e të punësuarve mbeti e pafavorshme, kështu që këtë vit në analizën dhe shqyrtimin e lëndëve drejtëpërdrejt u përfshinë vetëm 10 të punësuar. Nuk ka ndryshuar as gjendja me strukturën udhëheqëse në Sekretariatit e KSHPK, pasi nga 17 pozicionet drejtuese, janë plotësuar vetëm tre.

Gjatë vitit 2020, KSHPK nuk e rriti numrin e të punësuarve sepse në periudhën e planifikimit dhe përgatitjes së Propozim-buxhetit për vitin 2020, në fazë përgatitjeje ishin analiza funksionale si dhe aktet e brendshme për sistematizim dhe organizimin e të punësuarve në KSHPK.

Për të realizuar kompetencën e KSHPK, neni 17 pika 25, në fillim të vitit 2020 KSHPK miratoi Kodin Etik për kryetarin dhe anëtarët e KSHPK, si dhe Udhëzimet për integritetin dhe sjelljen etike për stafin e KSHPK, me të cilat përkufizohen parimet, vlerat dhe normat e sjelljes për të gjithë të punësuarit.

Në shkurt të vitit 2020, për të punësuarit e Sekretariatit të KSHPK u miratuan Rregullat e rendit të brendshëm dhe disiplinës.

3. Aktivitete të realizuara që burojnë nga kompetencat ligjore të KSHPK

3.1. *Strategjia Nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave*

Miratimi i Strategjisë Nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (më tutje në teks: Strategjia Nacionale) është kompetenca e parë dhe jashtëzakonisht e rëndësishme e parashikuar nga Ligji i ri për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Në vitet e fundit, KSHPK ka miratuar dhe zbatuar programet shtetërore për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave, por fakti që për herë të parë kjo Strategji miratohet nga Kuvendi i RMV, flet për vendosmërinë dhe gatishmërinë e shtetit për të forcuar parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, me përfshirje të të gjithë subjekteve relevante të sistemit në gjenerimin e një dokumenti kaq të rëndësishëm strategjik. Procesi i miratimit të Strategjisë Nacionale 2020-2024 filloi në shtator të vitit 2019 dhe duke u bazuar në analizën e përgatitur të rreziqeve për korrupsion, Metodologjinë e miratuar për përgatitjen e strategjisë kombëtare, përfshirjen e shumë organeve shtetërore, institucioneve, shoqatave, fondacioneve, sektorit privat, mediave, prezentimeve para opinionit publik, më 17 janar të vitit 2020 e paraqiti atë në Kuvendin e RMV për miratim.

Duke pasur parasysh që më 16.02.2020 u shpallën zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të cilat për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia *Kovid-19* u shtynë dhe u mbajtën më 25.07.2020, përbërja e mëparshme e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dështoi ta shqyrtojë dhe miratojë Strategjinë Kombëtare. Në pajtim me nenin 178 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së Kuvendit të RMV, me përfundimin e mandatit të Kuvendit përfundojnë të gjitha procedurat legjislative dhe procedurat për miratimin e akteve tjera të filluara gjatë periudhës së mandatit. Kjo nënkuptonte që KSHPK duhej përbërjes së re parlamentare sërish t'ia dorëzojë Strategjinë Nacionale për miratim.

Nga rrethanat e sipërpërmendura dhe faktin që një pjesë integrale e Strategjisë Nacionale është Plani i Veprimit, i cili përcakton qartë aktivitetet dhe afatin për zbatimin e tyre, mosmiratimi i Strategjisë Nacionale vuri në dyshim afatet për zbatimin e disa aktiviteteve. Duke pasur parasysh këto rrethana, por edhe faktin që para shpërbërjes së Kuvendit u miratuan një numër ligjesh që mbulonin disa aktivitete nga Strategjia Kombëtare, KSHPK vlerësoi se është e nevojshme që para dorëzimit të Strategjisë Nacionale në Kuvendin e RMV, të bëhet azhurnimi i afateve kohore dhe aktiviteteve të parashikuara për realizimin e saj. Këtë aktivitet KSHPK e realizoi në konsultim me të gjitha institucionet e ngarkuara për zbatimin e masave, aktiviteteve dhe afateve, në përputhje me Planin e Veprimit të Strategjisë Nacionale.

Pas azhurnimit dhe harmonizimit të masave, aktiviteteve dhe afateve për zbatimin e tyre, në një seancë të mbajtur më 11.12.2020 KSHPK miratoi Strategjinë Nacionale (të rishikuar) për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave me Planin e Veprimit 2021-2025, dhe e dorëzoi atë për miratim në Kuvendin Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Masat dhe aktivitetet e propozuara kanë të bëjnë me sektorët në vijim:

1. Sistemin politik;
2. Gjyqësorin;
3. Organet për zbatimin e ligjit;
4. Shëndetësinë;
5. Arsimin;
6. Punën dhe politikën sociale;
7. Urbanizmin dhe planifikimin hapësinor;

8. Mjedisin jetësor;
9. Sportin;
10. Ekonominë dhe biznesin;
11. Ndërrmarrjet publike dhe shoqatat akcionare në pronësi shtetërore dhe njërive të vetëqeverisjes lokale
12. Mediat dhe organizatat e shoqërisë civile

Pritshmëritë janë se zgjidhjet e ofruara në Startegjinë Nacionale do të mundësojnë:

- Punësime në sektorin publik, në bazë të meritave, transparencë, zvogëlim të ndikimeve politike ose personale, kufizim të rreptë të kompetencave diskrete;
- Forcim të mekanizmave të kontrollit në lidhje me realizimin efikas dhe efektiv të punëve nga sektori publik, veçanërisht në fushën e prokurimit publik dhe dhënien e lejeve, licencave të ndryshme...;
- Pavarësi më të madhe, profesionalizëm dhe efikasitet të të punësuarave në organet e zbatimit të ligjit dhe transparencë të shtuar të punës së tyre;
- Ndërtim dhe forcim të integritetit dhe përgjegjësisë së të gjithë bartësve të funksioneve publike, si dhe promovim të sjelljes, në përputhje me kodet etike dhe vlerave.

Është planifikuar që procesi i monitorimit të përmbushjes kuantitative dhe kualitative të masave dhe aktiviteteve të Strategjisë Nacionale, të kryhet përmes një aplikacioni në internet, të siguar me projektin e BE: *Transparenca dhe llogaridhënia*, e mbështetur nga IPA, zbatimi i së cilës është në realizim e sipër.

Shqyrtimi i lëndëve


Kompetencat për shqyrtimin dhe konstatimin e dyshimeve për sjellje korruptive, konflikt të interesave, mosdeklarim të pasurisë dhe interesave, verifikimin e deklaratave të pasurisë, etj., KSHPK i mbështet në parashtresat e personave juridikë ose fizikë (anonimë ose të njohur), me vërejtje të drejtpërdrejtë ose me vetiniciativë, por edhe në planet e tij vjetore.

Edhe gjatë vitit 2020, në KSHPK u dorëzuan një numër i madh i parashtresave për të gjitha fushat e paraqitura në Tabelën 3:

Tabela 3: Statusi i lëndëve në bazë të parashtresave të pranuar, me vetiniciativë dhe vendimmarrja

Fusha e veprimit	Korrupsion		Konflikt interesash		Pasuri		Financim i fushatave zgjedhore		Gjithsej	
	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019
Parashtresa të pranuar	406	687	80	364	32	67	32	54	550	1172
Me vetiniciativë	12	23	6	66	83	153	1	3	102	245
Numri i vendimeve të marra	378	100	157	143	38	83	33	38	606	364

Nëse analizojmë të dhënat vetëm për vitin 2020, është e qartë se, ashtu si edhe në vitin 2019, shumica e parashtresave të dorëzuara janë pretendime për sjellje të dyshimta korruptive të zyrtarëve (Grafiku 1).



Grafiku 1

Duke parë domosdoshmërinë për të dhëna dhe informata sipas fushave përkatëse, institucioneve, profesioneve, proceseve ose fenomeneve për të cilat më së shumti raportojnë qytetarët ose mediat mbi dyshimet për veprime të paligjshme, KSHPK gjatë vitit 2020 zhvilloi një aplikacion që mundëson diferencimin e aplikimeve sipas fushave: pushteti ekzekutiv, gjyqësori, arsimi, shëndetësia, urbanizmi, qeverisja lokale..., por edhe sipas llojeve të problemeve: realizimi i prokurimeve publike; punësimi; inspektimi; dhënia e vendimeve, licencave dhe lejeve; vendimet e gjykatave, etj., me qëllim përcaktimin e zonave me rrezik më të lartë për korrupsion.

Grafiku 2 tregon fushat për të cilat shumica e parashtresave tregojnë parregullsi.

Grafiku 2: Fusha me numër më të madh parashtresash për parregullsi




RAPORTI VJETOR PËR PUNËN E KSHPK PËR VITIN 2020

Për shkak të faktit se aplikacioni është në funksion nga maji i vitit 2020, një numër i madh i parashtresave të dorëzuara paraprakisht nuk u përfshinë dhe mbetën si të papërcaktuara (384 raporte korrupsioni, 70 raporte konflikti interesash dhe 51 raporte nga verifikimi i pasurisë).

Pavarësisht kësaj, parashtresat e analizuar – 436 të tilla, konfirmojnë faktin se gjyqësori, ekzekutivi, institucionet që vendosin në fushën e planifikimit urban dhe komunat, perceptohen si zona me rrezik më të lartë korrupsioni, keqpërdorim detyre dhe mundësisë për konflikt interesi, që përputhen me fushat e definuara në Strategjinë Nacionale për luftë kundër korrupsionit.

Më tutje, duke analizuar se për cilat fenomene apo procese më së shumti paraqiten pretendime për veprime joligjore, përmes parashtresave të shqyrtuara u konfirmua fakti se më së shumti raportohet për keqpërdorim të detyrës gjatë punësimeve, dhënien e lejeve të ndryshme (për ndërtim) dhe ekzistimin e konfliktit të interesave gjatë marrjes/ së vendimeve gjyqësore etj. Të gjitha këto paraqiten në Grafikon 3.

Grafiku 3: Shkelje e kompetencave të cilave u referohen parashtresat




Gjatë vitit 2020, KSHPK mbajti gjithsej 21 seanca, të cilat, për shkak të kushteve të imponuara për respektimin e masave shëndetësore për mbrojtje nga virusi *Kovid-19*, u mbajtën *online*, përmes platformës *zoom*. Hyrja iu lejua të gjithë transmetuesve dhe mediave elektronike që treguan interes për të ndjekur seancat.

Neni 22 i LPKKI: Seancat e Komisionit:

- (1) Komisioni Shtetëror merr vendimet për kryerjen e veprimtarive brenda kompetencës së tij në një seancë të kryesuar nga kryetari i Komisionit Shtetëror, me shumicë votash nga përbërja e përgjithshme e Komisionit Shtetëror;
- (3) Seancat e Komisionit Shtetëror janë të hapura për publikun;
- (4) Paragrafi (4) i këtij neni bën përjashtim në rastet kur publiku mund të mos lejohet të ndjekë seancën kur shqyrtohen lëndë që përmbajnë informata dhe të dhëna të klasifikuara, të mbrojtura me ligj.

Në seancat e mbajtura, u morën 606 vendime, të cilat paraqiten në Grafikon 4 sipas fushës së kompetencës së KSHPK.



Grafiku 4: Vendime që janë marrë sipas fushës së kompetencës

Efektet nga vendimet e që janë marrë për secilën fushë veç e veç, janë paraqitur në pikat 4.2., 4.3., 4.4. dhe 4.5. të këtij Raporti.

Neni 17 i LPKKI: KSHPK ka këto kompetenca:

pika 4: ngre iniciativë para organeve kompetente për inicim procedure verifikimi të përgjegjësisë së zyrtarëve;

pika 5: ngre iniciativë për inicim procedure për ndjekje penale në lëndët që shqyrton

Në kuadër të kompetencave të sipërpërmendura, e që burojnë nga shqyrtimi i lëndëve, KSHPK dorëzoi iniciativa për shqyrtim edhe në organe tjera kompetente. Statusi i iniciativave të dorëzuara dhe përgjigjet e institucioneve për këto, paraqiten në Tabelën 4.

RAPORTI VJETOR PËR PUNËN E KSHPK PËR VITIN 2020

Tabela 4: Pasqyrë e iniciativave të paraqitura dhe statusi i tyre

Numri rendor	Institucioni	Iniciativa të dorëzuara		Të shqyrtuara		Iniciativa të refuzuara		Pa përgjigje		Procedura në Gjykatën Administrative		Afati për përgjigje nuk ka skaduar	
		Konflikt	Korrupsion	Konflikt	Korrupsion	Konflikt	Korrupsion	Konflikt	Korrupsion	Konflikt	Korrupsion	Konflikt	Korrupsion
1	Qeveria e RMV	2	9		4		2	2	3				
2	Kryetarët e komunave	5	3	2		2	1	1					2
3	Shërbimet inspektuese	1	3	1	3								
4	Ministria e Shëndetësisë	4	3		1			1	2	2		1	
5	Ministria e Kulturës	1		1									
6	Ministria e Arsimit		3						3				
7	OJQ dhe BD	10	1	5		5	1						
8	Prokuroria Themelore Publike	2	8			2	2		5				1
9	Tjera	2	1	1				1			1		
	Gjithsej	27	31	10	8	9	6	5	13	2	1	1	3
	Gjithsej	58		18		15		18		3		4	
	në %			31%		26%		31%		5%		7%	

Statusi i iniciativave të dorëzuara paraqitet në formë kumulative për të gjitha iniciativat që janë dorëzuar gjatë viteve 2019 dhe 2020, si dhe veprimet e institucioneve lidhur me këto lëndë.

3.2. Procedimi në raste dyshimi për korrupsion

Korrupsioni nënkupton abuzim detyre, autorizimi publik, detyrës zyrtare ose pozitës, për të përfituar, drejtpërdrejt ose përmes një ndërmjetësi, për veten ose për një person tjetër

Nëse marrim si pikënisje definicionin e LPKKI më lartë, Komisioni Shtetëror ka rol të veçantë në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke ushtruar kompetencat e veta në drejtim të detektimit të fenomeneve dhe rasteve të korrupsionit, dhe procesimit të tyre adekuat, përmes zbatimit të mekanizmave parandalues dhe represivë ligjor me të cilat disponon, e gjitha këto me qëllim të përmirësimit të ambientit normativ në vend, forcimit të bashkëpunimit ndër-institucional, rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik për rëndësinë e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit dhe detektimit të tij, si dhe përfshirjen e palëve të interesit në kapërcimin e kësaj të keqe shoqërore.

KSHPK, me vetiniciativë, informatë nga mediat (me vërejtje të drejtpërdrejtë) ose parashtrës nga qytetarë, persona juridikë apo organizata të shoqërisë civile, hap lëndë dhe shqyrton dyshimet për korrupsion. Në përputhje me nenin 23 të LPKKI, për të konstatuar plotësisht situatën faktike, KSHPK kërkon të dhëna dhe informata nga institucionet kompetente, personat juridikë dhe fizikë, me çka personit përgjegjës në institucionin kompetent ose një

personi të autorizuar prej tij, i kërkohet të ndërmarrë të gjitha masat dhe aktivitetet për të siguruar informatën e kërkuar jo më vonë se 15 ditë nga dita e pranimit të kërkesës së KSHPK. Dispozitat ligjore që parashikojnë gjoba të larta për personat përgjegjës në institucione, ose personat e autorizuar prej tyre për mossigurimin në kohë ose mosdorëzimin e dokumentacionit të kërkuar¹, i mundësuan KSHPK që në kohë të duhur të kishte në dispozicion dokumentacionin përkatës dhe mbështetës për të konstatuar gjendjen faktike, për të verifikuar dyshimet ose për t'i refuzuar pretendimet e parashtresave, si dhe të ndërmarrë veprime konkrete, gjegjësisht ngritjen e iniciativave për procedim para autoriteteve kompetente ose dorëzimin e rekomandimeve dhe sugjerimeve në institucionet kompetente shtetërore.

Ashtu si edhe në vitin paraprak 2019, në 2020 KSHPK pranoi një numër të madh të parashtresave për korrupsion ose veprime të paligjshme nga zyrtarë dhe persona përgjegjës në sektorin publik. Statusi i parashtresave të pranuar sipas viteve, tregohet në Tabelën 5.

Tabela 5: Pasqyra e parashtresave të pranuar dhe lëndë të hapura

Lëndë të hapura	Numri i lëndëve të evidentuara		
	2020	2019	2018
Me vetiniciativë	12	23	nuk ka
Parashtresa nga qytetarë	406	687	89
Gjithsej:	418	710	89


Në Grafikon 5 paraqiten fushat për të cilat ka numër më të madh të parashtresave.



Grafiku 5

¹ Neni 100: “Do t'i shqiptohet gjobë prej 200 deri në 400 euro në kundërvlerë denarësh personit përgjegjës në institucionin kompetent ose personit të autorizuar nga personi përgjegjës, i cili nuk ndërmerr të gjitha masat dhe aktivitetet për sigurimin e informacioneve të kërkuara nga Komisioni Shtetëror dhe nëse këto nuk ia dorëzon Komisionit më së voni 15 ditë nga pranimi i kërkesës”

Gjatë përpunimit të pjesërishëm të të dhënave nga parashtrësasat për korrupsion, sërish u vërtetuan rreziqet të cilat KSHPK i përfshiu në Startegjinë Nacionale në raport me obligimet dhe kompetencat ligjore të institucioneve shtetërore. Proceset që kanë të bëjnë me kontratat e punës, dhënies së lejeve, licencave... edhe më tej paraqesin aktivitete me rrezik më të lartë për aktivitete korruptive të personave përgjegjës. Grafiku nr.6



Grafiku 6

Sa i përket shqyrtimit të KSHPK të parashtrësave nga fusha e korrupsionit, KSHPK mori vendim për 378 lëndë, të paraqitura në Tabelën 6.

Tabela 6: Statusi i shqyrtimeve sipas lëndëve

Procedimet e KSHPK	2020	2019
Numri i lëndëve të zgjedhura	378	100
Vendime që janë marrë	378	104
○ Parashtrësas të refuzuara – jokompetencë për shqyrtim ose nuk ka mjaftueshëm elementë për shqyrtim	116	60
○ Parashtrësas i përcillet organeve tjera për shqyrtim kompetent	6	2
○ Ndalim i procedurës – akuzat nuk janë vërtetuar	256	38
Lëndë për të cilat janë ndërmarrë masa konkrete	13	15
Iniciativa të dorëzuara në Prokurorinë Themelore Publike	2	6
- Iniciativa të pranuar		1
- Iniciativa të refuzuara		2
- Vlerësim i iniciativave	2	4
Iniciativa në institucione kompetente për konstatim të përgjegjësisë së personave përgjegjës dhe zyrtarëve	11	9
➤ Iniciativa të pranuar	3	5
➤ Iniciativa të refuzuara	4	1
➤ Institucionet akoma shqyrtojnë lëndën	4	3
Rekomandime që u janë dorëzuar institucioneve për ndërmarrjen e masave konkrete	3	6

Vendimet për refuzimin e parashtresave për shkak se KSHPK nuk ishte kompetente për të vepruar, në të shumtën e rasteve kishin të bëjnë me parashtresa lidhur me vendime gjyqësore nga gjykatat themelore dhe ato më të larta. Në këto raste më së shpeshti shprehet pakënaqësi nga vendimet e marra: pagesë dënimi, gjobë, vërejtje lidhur me zhvillimin e vetë procesit, për procese që akoma zhvillohen në instanca më të larta gjyqësore, pa indikacione për aktivitete korruptive. KSHPK nuk ka kompetencën të vlerësojë nëse proceset gjyqësore janë zhvilluar në përputhje me ligjet materiale dhe procedurale, dhe nëse vendimi gjyqësor është marrë në bazë të provave materiale. Një pjesë të këtyre parashtresave KSHPK ia dorëzon Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shqyrtim të mëtejme kompetent.

Numri i vendimeve të marra për ndalim të shqyrtimeve – 256 të tilla, është rezultat i veprimeve të KSHPK për parashtresa për të cilat nga institucionet përkatëse janë siguruar prova të nevojshme për të konstatuar gjendjen faktike pas pretendimeve të deklaruara, por për shkak të zgjidhjeve ligjore në ligjet materiale, KSHPK nuk është në gjendje të ndërmarrë masa për të ndaluar fenomenin, për të ndëshkuar personat përgjegjës ose për të filluar procedurë para gjykatave kompetente. Rrethanat e këtyra kanë të bëjnë me proceset në vijim:

➤ ***Punësimet në institucione shëndetësore dhe shoqëri aksionare***

Punësimet në institucionet shëndetësore publike (më tutje në tekst: ISHP) realizohen në përputhje me Ligjin për mbrotje shëndetësore, ku mënyra e vlerësimit rregullohet qartë në varësi të nivelit të arsimit (neni 160). Ky nen përcakton se zgjedhja e kandidatit me arsim të mesëm dhe të lartë bëhet në bazë të mesatares së suksesit që kandidati ka arritur në shkollën e mesme, përkatësisht në institucionin e arsimit të lartë – 50 pikë dhe pjesa profesionale (test) – 50 pikë. Më tej, në nenin 161 të po këtij ligji thuhet:

“Organi ekzekutiv i institucionit shëndetësor, bazuar në një listë rangimi të propozuar nga komisioni përzgjedhës me të paktën tre kandidatë, nëse ka më shumë se tre kandidatë që plotësojnë kriteret, zhvillon një intervistë dhe merr vendim për zgjedhjen e një kandidati”.

Nga trajtimi i këtyre çështjeve, KSHPK konstatoi se e drejta e dhënë organit drejtues për të marrë një vendim mbi përzgjedhjen pas një interviste, përdoret për të punësuar kandidatë që shpesh kanë fituar më pak pike, ndërsa kandidatët më të vlerësuar nuk janë punësuar. As ligji, as aktet nënligjore nuk kanë rregulluar mënyrën e zhvillimit të intervistës me pyetje të strukturuar dhe vlerësim të saj. Në këtë mënyrë, duke shfrytëzuar të drejtën diskrete, efektet nga intervista kanë më shumë vlerë dhe janë një faktor vendimtar në përzgjedhjen e kandidatit, në vend të suksesit dhe pikëve të fituara.

Në shoqëritë aksionare, punësimet kryhen në përputhje me Ligjin për marrëdhëniet e punës, ku nuk janë përcaktuar kurrfarë rregullash dhe normash për vlerësimin me pikë, në bazë të arsimit, përvojës së punës, kualifikimeve tjera dhe të ngjashme. Procesi i punësimit është i ndarë mes komisioneve për verifikimin administrativ të dokumenteve të dorëzuara, ndërsa vendimmarrja është e drejtë ekskluzive e personit përgjegjës në kompani. Një praktikë e shpeshtë, të cilën KSHPK rregullisht e konstaton gjatë shqyrtimit të këtyre lëndëve, është ndryshimi i sistematizimeve, me ç'rast krijohen vende të reja pune, ndryshohen kualifikimet për llojin e arsimit, përvoja e kërkuar e punës dhe ngjashëm, me qëllim që ato t'u përshtaten kualifikimeve të personave paraprakisht të përzgjedhur që të punësohen. Lë përshtypje fakti që në asnjë nga këto lëndë, KSHPK mes anëtarëve të bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse si organe që kontrollojnë punën e personave përgjegjës, nuk ka hasur në rrezistencë ose mospajtim për punësimet e bëra. Kjo tregon për lidhshmërinë dhe ekzistimin e interesit reciprok.

Këto punësime në opinion perceptohen si punësime me nepotizëm, kronizëm, klientelizëm, lidhshmëri partiake, që nga ana tjetër krijon pakënaqësi të madhe mes qytetarëve, ndjenjë pabarazie dhe rrezikim të së drejtës së garantuar kushtetuese për kushte të barabarta dhe mundësinë për ta fituar secilin konkurs të shpallur për vend pune.

➤ **Zgjedhja dhe shkarkimi i drejtorëve të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare**

Zgjedhja dhe shkarkimi i personave përgjegjës në shoqëritë aksionare dhe ndërmarrjet publike zakonisht ndodh paraprakisht dhe shpesh bëhet më “sugjerim” ose “rekomandim” të themeluesit (nga Qeveria e RMV dhe NjVL). Megjithëse dispozitat e neneve 367, 368 dhe 384 të Ligjit për shoqëritë tregtare dhe neneve 19, 19-a, 23, 23-a, 24-a të Ligjit për ndërmarrjet publike kërkojnë plotësimin e disa kushteve dhe procedurave për shkarkimin dhe përzgjedhjen e tyre, praktika e vendosur sugjeron procedura të tjera. Në fakt, rrallë merren parasysh kushtet për shkarkim në nenin 24-a të Ligjit për ndërmarrjet publike², ndërsa në “shpalljen e publikuar për zgjedhjen e një drejtori” gjithmonë paraqitet vetëm një kandidat, zakonisht personi i cili është planifikuar paraprakisht për atë pozicion.

Edhe pse ligjet e cekura më sipër përcaktojnë kualifikimet e duhura (shkallën e arsimit, përvojën e punës, njohjen e gjuhëve të huaja dhe ngjashëm), aktet për sistematizimin e vendeve të punës zakonisht nuk parashohin pozicionin e drejtorit (apo zëvendës drejtorit të NP të themeluar nga Qeveria e RMV), ndërsa në rastet kur ato përcaktojnë pozicion të tillë, nuk parashihet niveli i arsimit që duhet ta ketë drejtori.

Praktika e këtillë për zgjedhje të drejtorëve, por edhe mosekzistimi i rregullave për krijimin e vendeve të punës dhe kompetencave të NP dhe ShA, është një menyrë e provuar e punësimit të personave që janë të lidhur me partitë politike, pavarësisht ekspertizës dhe aftësisë së tyre, dhe kjo përcaktohet si një ndarje menaxhimi e institucioneve shtetërore ndërmjet partive politike në pushtet. Në këtë mënyrë, asnjëherë nuk është marrë parasysh nëse ekziston nevoja për të ndryshuar personat përgjegjës, e aq më pak nëse kjo ndodh për shkak të rezultateve të punës, ashtu si dhe që asnjëherë nuk është kërkuar përgjegjësi për rezultatet negative financiare të treguara.

² Drejtori i ndërmarrjes publike dhe zëvendës drejtori i ndërmarrjes publike të themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut shkarkohet para përfundimit të mandatit, në rastet siç vijon:

- me kërkesë të tij/saj,
- nëse ndodh një nga arsyet që parasheh ligji, për shkak të të cilave sipas rregullave për marrëdhënie pune, i ndërpritet marrëdhënia e punës konform ligjit,
- nëse nuk punon dhe vepron konform ligjit, statutit dhe akteve të ndërmarrjes publike apo pa arsye nuk zbaton vendimet e bordit drejtues ose vepron në kundërshtim të tyre,
- nëse me punën e tij/saj të pandërgjegjshme dhe të parregullt i shkakton dëm ndërmarrjes publike,
- nëse anashkalon ose nuk kryen detyrat dhe me këtë rrjedhimisht do të ndodhin çrregullime në kryerjen e veprimtarisë me interes publik të ndërmarrjes publike,
- nëse nuk dorëzon raport konform nenit 23-a paragrafi 1 të këtij ligji,
- nëse edhe pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 23-a paragrafi 3 të këtij ligji, nuk mënjanon mangësitë apo edhe nëse brenda atij afati sërish ka mangësi dhe/ose humbje në punën financiare dhe
- nëse edhe pas skadimit të afatit të paraparë në nenin 5 paragrafi 3 dhe nenin 7-a paragrafi 1 të këtij ligji, nuk publikon në faqen e internetit të ndërmarrjes publike raportin tremujor, i cili përmban indikatorë për punën financiare, llogarinë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike.

➤ **Emërim i shumëfishtë i kryesit të detyrës – Drejtor**

Disa ligje materiale përcaktojnë qartë se “nëse një drejtor nuk zgjidhet pas konkursit të shpallur, organi drejtues³ do të emërojë kryes detyre – drejtor, por jo më shumë se gjashtë muaj”.

Një numër i madh i parashtresave i janë dorëzuar KSHPK pikërisht për emërim të shumëfishtë për kryes detyre. Nga dokumentet e pranuar u konfirmuan veprimet e paligjshme të organeve qeverisëse, por KSHPK realisht nuk ka mundësi të ngrejë iniciativa para gjykatave përkatëse, sepse asnjë nga ligjet e sipërpërmendura, madje as Ligi për vetëqeverisje lokale, nuk parashohin sanksione për veprimet e këtilla.

Kjo mënyrë zgjedhje mundëson emërimin e personave të përshtatshëm për persona përgjegjës në institucione, trajtimin klientelist të personave të zgjedhur ndaj organeve të caktuara qeveritare, me pritshmëri për t'u përzgjedhur drejtorë me mandat të rregullt/, me çka rrezikohet funksionimi i rregullt i institucioneve dhe realizimi i qëllimeve të tyre ligjore.

➤ **Dëshmi për njohje të gjuhës së huaj**

Të gjitha ligjet materiale që rregullojnë mënyrën e punësimit të personave përgjegjës ose drejtorëve, definojnë kushtet dhe kualifikimet që duhet t'i përmbushë kandidati që të mund të zgjidhet. Ndër kushtet e kërkuara, parashihet edhe paraqitja e provave⁴ për njohjen e një prej tre gjuhëve më të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht).

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekziston organ shtetëror që ka njohuri se cilat subjekte japin diploma, vërtetime ose çertifikata për njohjen e një gjuhe të huaj dhe për më tepër, nëse këto njihen ndërkombëtarisht. Në kushte të një zbrazëtire të këtillë ligjore, nga dokumentacioni që siguroi KSHPK gjatë shqyrtimit të lëndëve, është e qartë se personat e zgjedhur kanë diplomë nga një “shkollë” jasht vendit ose nga vendi, pa prova për ekuivalencën e tyre në përputhje me standardet e kërkuara. Për më tepër, në raste të caktuara në dokumentet e dorëzuara për arsimin e kryer, nuk ka tregues se ata kanë mësuar gjuhën për të cilën kanë dorëzuar vërtetim.

Ky fenomen, së bashku me gjendjen në pikët e përmendura më lartë, flasin për një keqpërdorim eklatant të detyrës zyrtare në emërimin e personave përgjegjës, sepse paraprakisht dihet se cili person do të zgjidhet, e këto prova dorëzohen vetëm për të përmbushur kriterin ligjor. Praktika e këtillë që në fillim minon **INTEGRITETIN** e personit të emëruar, e me këtë vë në dyshim edhe integritetin e vetë institucionit.

Ajo që është edhe më shqetësuese është se një sferë tjetër në arsim është devalvuar plotësisht, për shkak të marrjes “së shpejtë” të diplomave, zakonisht të blera me para.

³ Neni 93-c i Ligjit për arsim të mesëm;

Neni 118 i Ligjit për arsim të mesëm;

Neni 19-a i Ligjit për ndërmarrje publike;

Neni 108 i Ligjit për mbrojtje shëndetësore;

⁴ Çertifikata ose vërtetime të pranuar ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetra se pesë vite, siç vijon: TOEFL iBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC Cambridge English: Legal – së paku niveli B2, FCE Cambridge English: First – provim i kaluar, BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2.

➤ **Zgjidhja e çështjeve të planifikimit urban: ndërtimi dhe shembja**

Një numër i madh parashtrësash të dorëzuara kanë të bëjnë me keqpërdorime të kompetencave nga persona dhe institucione që kanë autorizim për dhënien e lejeve për ndërtim. Në veprimet e shumta, dokumentacioni i siguruar tregon mangësi të shumta ligjore, që përdoren me shumë shkathtësi nga investitorët e interesuar për të arritur qëllimet e tyre - ndërtimin, por edhe nga autoritetet kompetente në drejtim të mosveprimit. Konkretisht:

- Mënyra e përzgjedhjes së operatorit ekonomik për përgatitjen e planeve të përgjithshme dhe të detajuara urbanistike në përputhje me Ligjin për prokurim publik, ku kriter për përzgjedhje është çmimi më i ulët, paraqet një rrezik të madh që komuna mos mund t'i imponojë standardet dhe kriteret e nevojshme për rregullim të humanizuar të hapësirës, por edhe rrezik për marrëdhënie klienteliste të operatorit ekonomik – planifikuesit me investitorë potencialë, në mënyrë që të plotësojnë kërkesat e tyre;
- Procedura jotransparente e miratimit të PDU dhe mosharmonizimi i tyre me PPU është arsye për dhënien e lejeve dhe ndërtimin e objekteve me përmasa më të mëdha, konsolidimin e parcelave pa zgjidhur marrëdhëniet pronësore-juridike, për të cilat zhvillohen procedura të gjata gjyqësore pa epilog, uzurpimin e pronës private etj.;
- Nuk ekziston mundësi ligjore për anulim ose suspendim të PDU, të miratuar pa harmonizim paraprak me PPU - (me këtë problem gjatë kohë ballafaqohet komuna Qendër);
- Aktivitetet e vetëqeverisjes lokale në sferën e planifikimit hapësinor nuk janë gjithmonë në drejtim të mbrojtjes së interesit publik:
 - ⇒ Disa nga komunat nuk kanë inspektorë të autorizuar;
 - ⇒ Disa nga komunat kanë inspektorë të autorizuar, por pa kualifikim adekuat;
 - ⇒ Ndikimi dhe pushteti i Kryetarit dhe Këshillit të Komunës, lidhshmëria me struktura partiake dhe grupe biznesi, i vendos inspektorët në situatë klientelizmi dhe neglizhim të interesit publik gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, por edhe në marrëdhënie klienteliste me investitorët;
 - ⇒ Numri më i madh i kryetarëve të komunave përmbahen nga shembja e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme dhe në buxhet nuk planifikojnë fare ose planifikojnë shumë pak mjete për këtë kompetencë. Në rast nevojë për rrënim, ata zakonisht u referohen mjeteve të paplanifikuara apo të pamjaftueshme për këtë qëllim.
- Kompetencat e Inspektoratit Shtetëror për Ndërtim dhe Urbanizëm përqendrohen në procedurat në raport me ndërtimet për të cilat leje për ndërtim jep Ministria e Transportit dhe Lidhjeve. Një kompetencë e tillë nuk mundëson krijimin e mekanizmave shtesë të kontrollit mbi aktivitetet e komunave, e as mbi inspektorët e autorizuar për të mbrojtur interesin publik, madje inspektorati nuk mund të marrë në kompetencën e tij as shembjen e ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme.
- Vazhdimi i shumëfishtë i afatit për zbatim të Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, ndërlikoi edhe më shumë procesin edhe ashtu të ndërlikuar të dhënies së vendimeve, për faktin se për këto ndërtime nevojitet ndryshimi i PDU-ve.
- Veprimet e vonuara dhe të pakoordinuara të vetëqeverisjes lokale dhe Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve krijuan kushte për ndërtimin e “**ndërtesave të forta**” në një zonë të mbrojtur, por edhe përdorimin e plazheve dhe realizim profiti, pa leje e licenca të dhëna.

Situatat e lartpërmendura, por edhe mosveprimi shumëvjeçar i organeve kompetente në lidhje me mosmiratimin e ligjeve adekuate për mbrojtjen e zonave të caktuara (Malin Sharr, Liqenin e Mavrovës dhe të tjera) dhe parandalimin e ndërtimit të pakontrolluar, kontribuan në shkatërrimin e mjedisit jetësor dhe rrezikimin e statusit të rajonit të komunave të Ohrit, Strugës

dhe Debërcës si rajon i trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore nën mbrojtje të UNESCO-s, por edhe të lokaliteteve tjera të mbrojtura, siç është gryka e Matkës...

Në shumë nga rastet e mësipërme, për të përcaktuar gjendjen faktike, u kërkua veprim kompetent nga organet e tjera, më së shpeshti nga inspektoratet, ku ata vetë kanë konfirmuar gjendjen, por edhe pamundësinë për të vepruar për shkak të mangësive sistematike në ligje.

Në drejtim të tejkalimit të të gjitha gjendjeve të konstatuara më sipër, KSHPK, përmes masave dhe aktiviteteve të propozuara në Startegjinë Nacionale për luftë kundër korrupsionit, kontroll të legjislacionit antikorrupsion, por edhe përmes projektit *Transparency International Makedonija* "Cenueshmëria e legjislacionit në lidhje me korrupsionin, vlerësimin e praktikave dhe procedurave për punësim, me fokus të veçantë në nepotizmin, kronizmin dhe klientelizmin", propozoi ndryshimin dhe plotësimin e mbi 50 ligjeve dhe akteve nënligjore, e gjithashtu propozoi edhe rreth 160 aktivitete për tejkalimin e dobësive të konstatuara dhe afate për realizimin e tyre.

Iniciativat e dorëzuara në Prokurorinë Themelore Publike

Në mënyrë që të përmbushë kompetencën për të filluar procedurat e ndjekjes penale⁵, KSHPK, bazuar në provat e siguruar, në Prokurorinë Themelore Publike ngriti dy çështje të cilat ajo i kishte shqyrtuar. Baza për paraqitjen e këtyre iniciativave, aktivitetet e realizuara, si dhe përgjigja e prokurorive përkatëse, paraqiten në **Shtojcën 1** bashkangjitur këtij Raporti.

Iniciativat e paraqitura në institucionet kompetente për përcaktimin e përgjegjësisë së personave udhëheqës dhe zyrtarëve

KSHPK ngriti iniciativa përpara organeve kompetente për fillim të procedurës për verifikimin e përgjegjësisë së zyrtarëve, në bazë të provave të siguruar për 11 lëndë të cilat kishte shqyrtuar⁶. Baza për paraqitjen e këtyre iniciativave, aktivitetet e realizuara, si dhe përgjigja e institucioneve përkatëse, paraqiten në **Shtojcën 2** bashkangjitur këtij Raporti.

Iniciativa tjera që burojnë nga lëndë të shqyrtuara

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Duke shqyrtuar lëndën për përgatitjen e PDU "Vendparkimi te Holiday Inn", në qershor të vitit 2020, KSHPK në Gjykatën Kushtetuese dorëzoi iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 64 të Ligjit për denacionalizim, i ndryshuar me Ligjin për ndryshime dhe plotësime të ligjit për denacionalizim (Gazeta Zyrtare e R.Maqedonisë nr.72/10). Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë iniciativën për vlerësim të kushtetutshmërisë së nenit 64 të Ligjit për denacionalizim, për shkak se "Gjykata tashmë ka vendosur mbi kushtetutshmërinë e tërë përmbajtjes së nenit të kontestuar 64 të ligjit, për ç'gjë ka marrë Vendimin U.nr.82/2011 nga 18 maji i vitit 2011, që sqaron se iniciativa e dorëzuar nuk përmban pretendime që do të kishin ndikuar që gjykata të marrë një vendim ndryshe.

Gjatë vitit 2019, KSHPK dorëzoi iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit për të drejtat e kryetarit të Republikës së Maqedonisë dhe familjes së tij, pas përfundimit të mandatit ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.46/04,109/06 dhe 157/07), për shkak se vetë ligji rrezikon parimin e barazisë së të gjithë qytetarëve para Kushtetutës dhe ligjeve, të cilën Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë në vitin 2020.

⁵ Neni 17 paragrafi 1 pika 5 e LPKKI

⁶ konform nenit 17 paragrafi 1 pika 4 të LPKKI

Rekomandimet dhe sugjerimet e dhëna

Duke shqyrtuar tre lëndë konkrete, KSHPK identifikoi situata që mund të krijojnë një rrezik për korrupsion, shkelje të parimeve të qeverisjes së mirë, sundim të së drejtës dhe integritetit personal e institucional dhe reputacionit të institucioneve gjatë ushtrimit të kompetencave publike. Prandaj, me qëllim të sigurimit të besimit të qytetarëve në kryerjen e funksioneve publike dhe në punën e institucioneve publike, respektivisht sigurimin e sjelljes së paanshme dhe të ndershme të zyrtarëve dhe personave përgjegjës në institucione, KSHPK u dërgoi institucioneve kompetente rekomandime për veprime konkrete për tejkalimin e situatave të konstatuara.

Komunës së Ohrit iu rekomandua zbatim joselektiv dhe i drejtë i rregulloreve në fushën e planifikimit urban të PDU-ve, dhe ndërtim dhe dhënie e lejeve për ndërtim në bazë të Planit Detal Urbanistik të miratuar, që ndjek kërkesat konkrete të qytetarëve ose personave juridik.

Duke shqyrtuar lëndën e njëjtë, KSHPK i dorëzoi **Qeverisë së RMV** kërkesë për shqyrtim dhe revokimin e kompetencave për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje në të gjitha komunitat e rajonit të Ohrit i cili është në mbrojtjen e UNESCO-s, dhe si bartës i pushtetit ekzekutiv, përmes Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, të merret me problemin e objekteve të ndërtuara pa leje në këtë rajon, gjegjësisht ta marrë përsipër përgjegjësinë për rrënim/shembje të ndërtimeve të egra në këtë rajon. Qeveria e RMV njoftoi se ka ngarkuar Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve ta shqyrtojë propozimin e dhënë dhe të japë mendim me udhëzime përkatëse për veprim të mëtutjeshëm.

Zëvendëskryetari për luftë kundër korrupsionit, zhvillim të qëndrueshëm dhe burime njerëzore, iu dorëzua rekomandimi për të inicuar miratimin e Ligjit të ri për Agjencinë e Inteligjencës, akteve të reja nënligjore për përkufizimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me punësimin, avancimin dhe mobilitetin, deri te sistematizimi, vlerësimi dhe transferit të kuadrove, për shkak se ligji aktual i Agjencisë së Inteligjencës si ligj material nuk paraqet kornizë mjaftueshëm të qartë për miratimin dhe zbatimin e akteve nënligjore dhe Marrëveshjes Kolektive për punësim, avancim dhe mobilitetet përmes sistematizimit, vlerësimit dhe transferit të kuadrove.

Bazuar në rreziqet e identikuara për korrupsion të mundshëm, **Komunës Qendër** iu dorëzua një rekomandim për përgatitjen dhe miratimin e planeve detale urbanistike, ekskluzivisht konform procedurave ligjore dhe me harmonizim paraprak me Planin e Përgjithshëm Urbanistik për Qytetin e Shkupit.

Ministrisë së Shëndetësisë iu sugjerua të gjejë zgjidhje ligjore në lidhje me punën dhe veprimet e institucioneve në RMV në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme, të shpallur për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve dhe situatën ekonomike në vend, në drejtim të parandalimit të mospërputhjeve dhe paligjshmërive të mundshme në veprimet e pushtetit qendror dhe atij lokal, si dhe të individëve dhe subjekteve në sektorit publik.

KSHPK rregullisht i dërgon njoftime Ministrisë së Shëndetësisë për personat përgjegjës/drejtorët në institucionet shtetërore publike, të cilët duke shfrytëzuar të drejtën diskrete nga neni 161 i Ligjit për mbrojtje shëndetësore, nuk kanë punësuar persona që pas vlerësimit kanë fituar më shumë pikë, por përzgjedhja ka qenë subjektive dhe të shumtën e rasteve ka lidhje me ndikime nga jashtë dhe keqpërdorim të detyrës, ose për të cilat ekziston konflikt interesi.

Aktivitetet e KSHPK në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme

Gjendja e jashtëzakonshme që zgjati prej 22.3.2020 deri më 23.6.2020, por edhe orientimi i institucioneve në drejtim të parandalimit të infektimit dhe zvogëlimin e pasojave nga kriza e *Kovid-19*, ngriti ndjeshmërinë e opinionit publik në lidhje rritjen e shpenzimeve të mjeteve publike për luftë kundër pandemisë, mjeteve që u akordohen subjekteve afariste dhe personave fizikë si ndihmë financiare, si dhe transparencën e alokimit dhe përdorimit të tyre. Në këtë kontekst, me qëllim të detektimit dhe parandalimit të sjelljes korruptive, KSHPK së bashku me institucione tjera dhe organizata qytetare, realizoi aktivitetet në vijim:

- me Platformën e organizatave joqeveritare për luftë kundër korrupsionit, u krye kontroll antikorrupsion i vendimeve të detyrueshme në fuqi, të miratuara nga Qeveria Teknike;
- me Entin Shtetëror për Revizion filloi auditimi i një pjese të prokurimeve publike të kryera për sigurimin e mjeteve dhe barnave në 14 institucione të administratës shtetërore. Përgatitja e raporteve finale është në proces;
- Me Qendrën për komunikime me qytetarë rregullisht ndiqet transparenca dhe konkurrenca në procedurat për prokurime publike, që zbatohen nga organet shtetërore përmes sistemit elektronik të Entit për Prokurime Publike.

3.3. Procedimi në raste të konfliktit të interesave

Neni 72 i LPKKI


- (1) Në punë, zyrtari është i obliguar të ketë kujdes për konflikt të mundshëm interesash dhe të ndërmarrë masa për shmangien e mundësisë së këtillë;
- (2) Në rast se ka dyshime për ekzistimin e konfliktit të interesave, zyrtari është i obliguar t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për ta parandaluar ndikimin e interesit të tij/saj privat apo interesin privat të një personi tjetër mbi zbatimin e autorizimeve dhe përgjegjësisë, dhe për këtë ta njoftojë eprorin e tij/saj.

Ndjeshmëria e rritur publike për këtë çështje, ka kontribuar për rritjen e numrit të parashtrësive për të gjitha format e konfliktit ndërmjet interesit publik dhe atij privat, që më së shumti theksohen në punësimet në sektorin publik, siç janë nepotizmi, kronizmi, klientelizmi, ndikimi politik dhe partiak. Tabela 7 tregon situatën në lidhje me parashtrësit e pranuar, me pretendime për konflikt interesi në tre vitet e fundit.

Tabela 7: Parashtrësia dhe lëndë të pranuar dhe evidentuara

Lëndë të hapura	Numri i lëndëve të evidentuara		
	2020	2019	2018
Me vetiniciativë	6	66	6
Parashtrësia nga qytetarë	80	364	75
Gjithsej:	86	430	81

Duke analizuar parashtrësit e dorëzuara sipas fushës së punës së institucioneve, numri më i madh i tyre u referohen zyrtarëve të pushtetit ekzekutiv dhe atij lokal, si persona që janë më së shumti të rrezikuar nga mundësia për konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksionit publik, ndërsa pasohen nga parashtrësit në fushën e arsimit dhe gjyqësisë. Gjendja paraqitet në Grafikon 7.



Grafiku 7

Lidhur me shqyrtimet e KSHPK të parashtresave nga fusha e konfliktit të interesave, KSHPK mori vendime për 157 lëndë, të paraqitura në Tabelën 8.

Tabela 8: Procedime nga sfera e konfliktit të interesave

Shqyrtime të KSHPK	2020	2019
Lëndë lidhur me pretendime për konflikt interesi	86	430
Kërkesa të dorëzuara për mendim, konform nenit 72 paragrafi 3	47	
Vendime të marra	157	143
Gjendja e konstatuar e konfliktit të interesave	8	
- Është vepruar në bazë të rekomandimeve të KSHPK për eliminimin e konfliktit të interesave	6	
- Procedimi i personave është në zhvillim e sipër	2	
Iniciativa të dorëzuara për përgjegjësi të personave zyrtarë për shkak të ekzistimit të konfliktit të interesit	7	
- Iniciativa të pranuar	4	
- Shqyrtimi nga institucionet është në zhvillim e sipër	3	
Iniciativa të dorëzuara për shkarimin e zyrtarëve për shkak të ekzistimit të konfliktit të interesave	2	
- Iniciativa të pranuar	1	
- Shqyrtimi nga institucionet është në zhvillim e sipër	1	

Parashtresa të dorëzuara për shqyrtim në institucione tjera, pas pretendimeve të verifikuara për ekzistimin e konfliktit të interesave	6	
Fletëurdhëresa për gjopa kundërvajtëse, për mosveprim lidhur me situatat ku është konstatuar konflikt interesi	20	
Kërkesë e dorëzuar për procedurë kundërvajtëse për mospagim të urdhër-fletëpagesave	5	

Iniciativa për fillimin e një procedure para organeve kompetente ndaj personave të caktuar, për shkak të ekzistencës së konfliktit të interesave

Rastet të cilat KSHPK shqyrtonte në fushën e konfliktit të interesave, kryesisht ndërlidheshin me ekzistencën e një konflikti në mes të interesit publik dhe atij privat të një personi të zgjedhur dhe të emëruar, që ka marrë pjesë në një procedurë për punësimin e personave të afërt, duke neglizhuar ndalesat dhe detyrimet për t'u distancuar nga ky proces, të parashikuara në nenet 72, 74 dhe 75 të LPKKI. Në nëntë raste, KSHPK konstatoi ekzistencën e konfliktit të interesave dhe keqpërdorimin e të drejtave diskrete, për të cilat institucioneve kompetente u dorëzoi iniciativa për përcaktimin e përgjegjësisë, gjegjësisht shkarkimin e personave përgjegjës. Pesë nga iniciativat e dorëzuara janë pranuar dhe për ato janë ndërmarrë veprime përkatëse, ndërsa për katër iniciativa procedurat janë duke vazhduar.

Arsyet për këto iniciativa dhe veprimet e institucioneve lidhur me këto lëndë janë paraqitur në **Shtojcën 3**.

Rekomandime pas shqyrtimit të lëndëve

KSHPK shqyrtonte një lëndë për të përcaktuar nëse ka konflikt interesi të ish-Ministrit të Financave, për shkak të tërheqjes së depozitit nga një bankë, përpara se Banka Popullore e RMV të marrë vendim për falimentimin e kësaj banke, vendim i cili pastaj u publikua në faqen e internetit të KSHPK. Nga inspektimi i “Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Bankës Popullore të RMV, Ministrisë së Financave dhe organeve të tjera rregullatore”, mbi bazën e të cilave është formuar Komisioni për Stabilitet Financiar dhe është përcaktuar mënyra e komunikimit të tyre të ndërsjellë, KSHPK konstatoi se ekziston nevoja për përmirësimin e këtij memorandumi, me qëllim që të shmangen dhe parandalohen konfliktet e interesit nga zyrtarët në kryerjen e detyrave të tyre, për të cilat BPRMV dha rekomandimin e duhur. **Banka Popullore** informoi se rekomandimi i dhënë është zbatuar me ndryshime dhe plotësime të Memorandumit, duke forcuar mënyrën e përdorimit dhe disponimit të informatave zyrtare, si dhe duke paraqitur dispozita të reja që përkufizojnë konfliktin e interesave dhe mënyrën për t'i parandaluar ato.

Në **Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës** u dërgua një rekomandim që në procedurën për emërimin e drejtorëve dhe personave përgjegjës, për emërimin e të cilëve kompetent është Ministri i Arsimit dhe Shkencës, gjegjësisht Kryetari i Komunës, është e nevojshme të merret parasysh integriteti i personit, respektivisht parimi i integritetit në pajtim me nenin 4 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave.

Kryetari të Komunës së Kërçovës i është dërguar një rekomandim që kur emëron drejtorë dhe persona të caktuar në funksione tjera, për emërimin e të cilëve sipas nenit 132 paragrafi 1 të Ligjit për Arsimin Fillor përgjegjës është kryetari i komunës, të marrë parasysh integritetin e personit të caktuar, të paraparë në nenin 4 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Kryetari të Komunës Qendër Zhupë i është dorëzuar një rekomandim mbi nevojën për të inçuar në Këshillin e Komunës shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Shkollës ShMK “ATA” Qendër Zhupë, për të cilët KSHPK konstatoi se janë në konflikt interes lidhur me zgjedhjen e drejtorit të shkollës. Pas zgjedhjes së këshillit të ri të shkollës, rekomandohet të zhvillohet një procedurë e rregullt për zgjedhjen e drejtorit të ShMK “ATA” Qendër Zhupë, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Mesëm.

Ministrit të Shëndetësisë iu dërgua një rekomandim, që kur emëron drejtorët e institucioneve shëndetësore publike dhe personat tjerë për ç’gjë ministri ka autorizim, të marrë parasysh dhe të respektojë dispozitat e neneve 4, 46 dhe 56 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Kontroll i deklaratave për konflikt interesash

KSHPK ka kompetenca ekskluzive të regjistrojë, monitorojë dhe verifikojë deklaratat e pasurisë dhe interesave. Sipas LPKKI, çdo person i zgjedhur ose i emëruar, person përgjegjës në një ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, është i detyruar në KSHPK të paraqesë deklaratën e pasurisë dhe interesave, jo më vonë se 30 ditë nga dita e zgjedhjes, emërimit, caktimit ose punësimit. Deklarata e interesave për të dhe anëtarët e familjes së tij/saj përmban informata në lidhje me vendet e punës dhe anëtarësinë në bordet drejtuese, anëtarësinë në shoqata dhe fondacione dhe të dhëna të tjera, në një format deklarate të cilin e definojnë KSHPK, personat juridikë të themeluar nga personi i zgjedhur ose anëtarët e familjes së tij. Për shkak se KSHPK nuk ishte në gjendje të sigurojë dorëzimin e Deklaratës në formë elektronike, gjatë vitit 2020, personat e përzgjedhur deklarorin interesat e tyre në formën e paraparë nga Ligji i mëparshëm për parandalimin e konfliktit të interesave. Arsyet e pamundësisë për të realizuar këtë kompetencë janë shpjeguar detajisht në pikën 4.5. të këtij raporti. Pasqyra me deklaratat e paraqitura të konfliktit të interesave paraqitet në Tabelën 9.

Tabela 9: Deklarata të dorëzuara për konflikt interesash

Viti	2020	2019	2018
Numri i deklaratave të dorëzuara	480	849	1650

Mënjanimi i gjendjes së konfliktit të interesave

Në rastet kur ekziston dyshimi për konflikt interesi, KSHPK fillon një procedurë për të konstatuar ekzistencën e konfliktit të interesave dhe merr masa të parapara me nenin 77 të LPKKI.

3.4. Mbikëqyrja e ligjshmërisë së financimit të fushatave zgjedhore

Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore ka qenë gjithmonë një sferë e ndikimit, presionit, keqpërdorimit të detyrave dhe funksioneve, me qëllim fitoren e zgjedhjeve dhe marrjen e pushtetit. Duke pasur parasysh parregullsitë nga zgjedhjet e zhvilluara në ciklet e mëparshme, të manifestuara përmes ndikimeve, presioneve, përpjekjeve për ryshfet votuesve, përdorimit të burimeve të paligjshme dhe anonime të financimit, keqpërdorimit të fondeve buxhetore dhe burimeve tjera të institucioneve shtetërore për qëllime partiake dhe zgjedhore, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE / ODIHR), viteve të kaluara disa herë radhazi ka dhënë rekomandime për forcimin e kapacitetit institucional të vendit për monitorim dhe kontroll efektiv, si të procesit zgjedhor, ashtu edhe të financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore.

LPKKI parasheh kompetenca, aktivitete dhe afate, në bazë të të cilave KSHPK ka autorizimin për të monitoruar partitë politike dhe fushatat zgjedhore:

Neni 31: Në rast të dyshimeve për **financim joligjor të një partie politike**, KSHPK me vetiniciativë ose me iniciativë të organeve shtetërore, partive politike ose shoqatave dhe fondacioneve që punojnë në fushën e parandalimit të korrupsionit, sundimit të ligjit apo qeverisjes së mirë, mund të marrë vendim për iniciimin e procedurës për hetim të financimit të partisë politike.

Neni 32: Në rast të **dyshimeve për financim joligjor të fushatës zgjedhore**, KSHPK me vetiniciativë ose në bazë të një parashtrere nga organizatori i fushatës zgjedhore apo mbikëqyrësve të akredituar, ngre procedurë për përcaktimin e gjendjes faktike.

Neni 33: KSHPK është i autorizuar **të ndjekë ligjshmërinë e përdorimit**, respektivisht të ketë në dispozicion **mjete buxhetore** që ga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e tyre.

Neni 35: Nëse paraqiten dyshime se një parti politike ose kandidat që në **zgjedhje kanë përdorur mjete të paligjshme ose mjete nga burime të panjohura**, KShPK do të kërkojë nga organet kompetente të kryejnë kontroll të burimit të mjeteve dhe t'i dorëzojnë Komisionit raport të detajuar për përdorimin e mjeteve.

Periodha dyvjeçare e funksionimit të KSHPK që nga shkurti i vitit 2019, ishte një periudhë dyvjeçare ciklesh zgjedhore: presidenciale – 2019, të parakohshme parlamentare – 2020 dhe zgjedhje të parakohshme për kryetar të Komunës së Pllasnicës dhe Komunës së Shtipit – 2020.

KSHPK përdori përvojën nga monitorimi i financimit të fushatave zgjedhore dhe zbatimin e neneve të LPKKI gjatë zgjedhjeve presidenciale në vitin 2019, për të zbuluar dobësitë, kufizimet dhe pengesat në LPKKI dhe Kodin Zgjedhor, në drejtim të përmbushjes së kompetencave të parapara. Në mënyrë që të kapërcehen dobësitë e identifikuar, brenda grupit të punës që gjatë vitit 2019 punoi në ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Zgjedhor, KSHPK, përmes përfaqësuesit të saj, mundësoi ndryshimin dhe plotësimin e disa neneve me qëllim forcimin e mekanizmave të kontrollit të KShPK, por edhe të institucioneve tjera që marrin pjesë në procesin zgjedhor. Por, përkundër ndryshimeve ligjore, KSHPK u përball me një sfidë për të organizuar burimet që kishte në dispozicion – njerëzore, financiare dhe kohën, për shkak të buxhetit të kufizuar, numrit të vogël të të punësuarve dhe pajisjeve të dobëta teknike dhe softuerike.

Për shkak të kushteve të veçanta të punës si rezultat i gjendjes së jashtëzakonshme të shkakuar nga kriza e *Kovid-19*, dekretet e detyrueshme të miratuara nga qeveria teknike e RMV gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, që patën efekt në procesin zgjedhor dhe organizimin e të punësuarve në sektorin publik, pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme më 13 qershor të vitit 2020 dhe njoftimit se zgjedhjet do të mbahen në korrik të vitit 2020, KSHPK me mbështetjen e IFES⁷ – Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore, filloi me zbatimin e një projekti për angazhimin e vëzhguesve të zgjedhjeve.

Qëllimi i këtij projekti ishte të siguronte dëshmi për të gjitha shpenzimet që dalin nga aktivitetet e përfaqësimit zgjedhor të partive dhe lidhjen e tyre me shpenzimet e paraqitura në pasqyrat financiare për fushatën zgjedhore, si dhe me burimet e siguruarat të financimit. Për këtë qëllim, u punësuan 17 vëzhgues, ndërsa KSHPK organizoi trajnim me qëllim që t'i njohtojë vëzhguesit për mënyrën se si partitë realizojnë parfaqësimin zgjedhor konform ligjit, çka pritet prej tyre të sigurojnë për KSHPK si vëzhgues, mënyrën si do ta realizojnë atë, e madje për vëzhguesit u

⁷ IFES - International Foundation for Electoral Systems

përgatit një Udhëzues veprimi, ku sqarohet se në cilat aktivitete të partisë vëzhguesit duhet të përqendrojnë vëmendjen e tyre dhe si t'i dokumentojnë ato. Të dhënat e siguruar, të kategorizuara sipas pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, iu dorëzuan Entit Shtetëror për Revizion, si dëshmi shtesë për të konfirmuar të hyrat dhe shpenzimet e publikuara gjatë auditimit të pasqyrave financiare.

Gjatë periudhës zgjedhore e cila zgjati nga 16.2.2020 deri më 21.3.2020 dhe nga 24.6. deri më 12.7.2020 (periudha nga 22.3.2020 deri më 23.6.2020 ishte periudhë e gjendjes së jashtëzakonshme), në KSHPK u dorëzuan **32** parashtresa, me pretendime për shkelje dhe mosrespektim të neneve 8-a dhe 8-b të Kodi Zgjedhor dhe dispozitat e nenit 34 të LPKKI, nga të cilat:

- 5 – parashtresa nga një organizator i fushatës zgjedhore;
- 6 – parashtresa ankimuese, të cilat KSHPK i trajtoi si parashtresa të rregullta, sepse nuk ishin dorëzuar nga një organizator i fushatës zgjedhore; dhe
- 21 – parashtresa nga persona fizikë/juridikë

Gjatë fushatës elektorale, KSHPK mbajti pesë seanca publike në Klubin e Deputetëve, konform kompetencave të parashikuara me nenin 33 të LPKKI.

Duke vepruar në bazë të pesë parashtresave të paraqitura, KSHPK miratoi:

- tre vendime për hedhjen poshtë të pretendimeve. Për një nga vendimet, parashtruesi ngriti padi në Gjykatën Administrative, por ajo u refuzua si e pabazë;
- dy vendime për të pranuar pretendimet, pas së cilës Qeverisë iu dorëzua një iniciativë për të përcaktuar përgjegjësinë e një personi të zgjedhur për shkelje të nenit 8-a, ndërsa vendimi tjetër u anulua nga Gjykata Administrative pas një ankese të paraqitur nga kryesi i shkëljes së nenit 8-a të Kodit Zgjedhor.

Lidhur me 27 parashtresat e paraqitura, KSHPK shqyrtoi të gjitha dhe miratoi:

- shtatë vendime për të ndaluar procedurën për shkak të pretendimeve të pakonfirmuara;
- njëmbëdhjetë vendime për të ndaluar procedurën për shkak të mungesës së elementeve për veprime të mëtejshme;
- gjashtë vendime për të refuzuar aplikimet;
- dy vendime për dorëzimin e aplikacioneve për shqyrtim kompetent tek organet e tjera;
- me një vendim konstatoi se pretendimet kanë bazë dhe vendosi një masë të përshtatshme për atë.

KSHPK me vetiniciativë ngriti edhe një procedurë për shkelje të nenit 8-a paragrafi 1 rreshti 3 të Kodit Zgjedhor, gjegjësisht shqyrtimin e procedurës për zgjedhjen e një rektori gjatë fushatës zgjedhore, por për shkak të mosbashkëpunimit të Rektoratit, KSHPK nuk ishte në gjendje të sigurojë dokumentet e nevojshme brenda afatit të parashikuar ligjor dhe të vendosë në një seancë, kështu që u detyrua të pezullojë procedurën me vetiniciativë, por të vazhdojnë në procedurë të rregullt, konform nenit 23 të LPKKI. Procedura është në zhvillim e sipër.

Duke u bazuar në analizën e raporteve për donacionet e pranuar në llogaritë bankare, si dhe raportet me specifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në këto llogari në lidhje me fushatën zgjedhore nga dita e fillimit të saj, KSHPK konstatoi gjetjet, si më poshtë:

- një parti politike nuk ka dorëzuar asnjë raport;
- dy parti kanë dorëzuar vetëm pasqyrën e përgjithshme financiare me specifikim të të ardhurave dhe shpenzimeve në fushatën zgjedhore;
- dy parti kanë dorëzuar raporte në formate që nuk i parasheh Kodi Zgjedhor

Kjo tregon se përkundër obligimit të detyrueshëm dhe afateve të përcaktuara qartë për paraqitjen e raporteve që parasheh Kodi Zgjedhor, pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore nuk e përmbushin atë plotësisht.

Nga analizimi i të dhënave në pasqyrat e përgjithshme financiare, me specifikim të të ardhurave dhe shpenzimeve në fushatën zgjedhore, të paraqitura nga pjesëmarrësit deri më 15.10.2020 (data e miratimit të Raportit Special për keqpërdorimet e identifikuara në financimin e fushatës zgjedhore), KSHPK konstatoi se për pjesëmarrës të caktuar në fushatën zgjedhore ekziston dyshimi për mosrespektim të dispozitës së nenit 83 paragrafi 2 rreshti 1, gjegjësisht mjetet nga llogaria e rregullt e partisë politike janë përdorur për financimin e zgjedhjeve, por edhe që ka indikacione për mbledhjen dhe përdorimin e fondeve në mënyrë të paligjshme ose nga burime të panjohura, në kundërshtim me nenin 35 të LPKKI. Në përputhje me kompetencat e tij të parashikuara në nenin 35 paragrafi 2, KSHPK në Entin Shtetëror për Revizion dorëzoi disa kërkesa për verifikimin e burimit të fondeve për pesë pjesëmarrës në fushatën zgjedhore, si dhe një kërkesë në Drejtorinë për Inteligjencë Financiare, për verifikimin e financimit të një pjesëmarrësi.

Pas njoftimit të marrë nga Drejtoria e Inteligjencës Financiare, në janar të vitit 2020, në Prokurorinë Publike u dorëzua iniciativa për ndjekjen penale të personave përgjegjës në një parti politike, për financimin e fushatës zgjedhore në mënyrë të paligjshme dhe nga burime të panjohura.

Kontrollet nga Enti Shtetëror për Revizion janë duke vazhduar.

Më 02.10.2020, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut solli vendimin me numër 09-3420/1, për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për kryetar të komunës së Pllasnicës dhe Komunës së Shtipit, për datën 13.12.2020, sepse pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, postet e kryetarëve të komunave mbetën të lira për shkak të emërimit të kryetarëve të komunave në poste të reja.

Në komunën e Pllasnicës kandidatë të tyre për kryetar komune propozuan partitë Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI dhe Lëvizja për Bashkim Kombëtar të Turqve-LBKT (*DNET*), ndërsa për Komunën e Shtipit: Integra, Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë-LSDM; Koalicioni: E ardhmja në duart tona (Demokratët, Organizata Reformuese Maqedonase për Bashkim, Partia e Punëtorëve); Grupi i votuesve – Trajcho Mitev dhe Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas-BPRm (*TMRO*).

Gjatë periudhës së zgjedhjeve nga 02.10.2020 deri më 13.12.2020, në KSHPK **nuk u dorëzua asnjë** ankesë për paligjshmëri të vërtetuara gjatë fushatës zgjedhore, dhe rrjedhimisht KSHPK nuk kishte nevojë të procedojë dhe të vendosë në seanca, në përputhje me procedurat e parapara në nenet 32. dhe 33 të LPKKI. Disa institucione paraqitën kërkesat për pëlqim në lidhje me kryerjen e prokurimeve publike ose punësimeve, të cilave KSHPK iu përgjigj se as Kodi Zgjedhor, e as Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nuk i mundëson KSHPK kompetencën për të dhënë pëlqime të tilla, ndërsa për vendimet që janë marrë nga personat përgjegjës lidhur me këto kërkesa, KSHPK do të veprojë në vijë zyrtare, nëse dorëzohen parashtrësia përkatëse.

Për të përmbushur detyrimin e raportimit në përputhje me nenin 36 të ligjit, në tetor të vitit 2020 KSHPK i dorëzoi Kuvendi të Republikës së Maqedonisë së Veriut Raportin Special mbi keqpërdorimet e identifikuara në financimin e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare – 2020, ndërsa në mars të vitit 2021 paraqiti Raportin Special mbi keqpërdorimet e konstatuara në financimin e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kryetar të Komunës së Pllasnicës dhe Komunës së Shtipit. Deri në përgatitjen e këtij Raporti Vjetor,

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ende nuk ka miratuar Raportin Special për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare – 2020. Raportet janë në dispozicion në faqen e internetit të KShPK⁸.

3.5. Evidentimi dhe mbikëqyrja e pasurisë

Neni 17 i LPKKI: Kompetencat e KSHPK

- (10) Evidenton dhe mbikëqyr pasurinë dhe interesat në procedim, konform këtij ligji;
- (11) Përcakton formatin e deklaratave të pasurisë dhe interesave;
- (12) Kryen kontrollë të deklaratave të pasurisë dhe interesave;
- (13) Bashkëpunon me organe tjera shtetërore në sigurimin e informatave të nevojshme;

Këto kompetenca duhet të ushtrohen duke mbledhur, evidentuar dhe analizuar të dhënat nga formulari *Deklarata e pasurisë dhe konfliktit të interesave*, i cili duhet të jetë i disponueshëm në formë elektronike dhe të dorëzohet në po atë mënyrë. Periudha për miratimin e formës së re të deklaratës së pasurisë dhe konfliktit të interesave, është 60 ditë nga dita e konstituimit të përbërjes së KSHPK, përkatësisht 08.04.2019 (neni 119 i LPKKI). Deri atëherë, në fuqi ishin aktet e vjetra⁹.

Edhe pse KSHPK definoi formatin e formularit *Deklaratë e pasurisë dhe konfliktit të interesave* brenda afatit ligjor, në mungesë të softuerit funksional për dorëzimin e deklaratës në formë elektronike, KSHPK e kishte të pamundur ta miratojë atë në vitin 2020. Pamundësia për të realizuar këtë kompetencë shumë të rëndësishme ishte rezultat i disa arsyeve:

- Projekti me USAID, i cili filloi në qershor 2019 dhe kishte për qëllim të sigurote mbështetje financiare për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit me specifikim teknik për zhvillimin e softuerit modular, që do të mundësojë edhe dorëzimin elektronik të formularit *Deklarata e pasurisë dhe konfliktit të interesave*, u ndërpre në nëntor të vitit 2019 me vendim të donatorit – USAID.
- Duke pasur parasysh që projekt-planet e buxhetit për vitin 2020 janë përgatitur dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave deri në gusht të vitit 2019, tërheqja e donatorëve në nëntor të vitit 2019 nuk i la hapësirë KSHPK për të planifikuar me kohë dhe kërkoi mjete për zbatimin e këtij projekti në vitin 2020. Me përpjekje maksimale, për këtë qëllim me Buxhetin e RMV për vitin 2020, u siguruan 10 milionë denarë për nevojat e KShPK.
- Pas Dekreteve të Qeverisë së RMV me fuqi ligjore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia *Kovid-19* e në lidhje me kufizimin e prokurimeve publike, pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme dhe zgjedhjes së qeverisë së re të RMV, gjatë muajit gusht të vitit 2020, në kuadër të 10 milionë denarëve të planifikuar, KSHPK filloi procedurën për prokurimin publik të një zgjidhjeje softuerike: dorëzimi elektronik i formularit *Deklarata për raportimin e pasurisë dhe interesave*, dhe formularit *Deklarata*

⁸https://old.dksk.mk/fileadmin/user_upload/2020/Poseben_Izveshta_za_utvrdeni_zloupotrebi_vo_finan_sira_e_na_izbornata_kampa_a_Parlamentari_izbori_2020.pdf

⁹ Neni 119 paragrafi 2 i LPKKI: Deri në miratimin akteve nënligjore të parapara me këtë ligj, do të zbatohen aktet nënligjore aktuale, të miratuara në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 dhe 148/15) dhe Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.70/2007, 114/2009, 6/12 dhe153/15).

për ndryshim në pronë dhe interesa. Për shkak të lëshimeve dhe mangësive të theksuara në specifikimin teknik, në shtator të vitit 2020 shpallja publik u anulua.

- KSHPK vlerësoi se për realizimin e kompetencave të tij në mënyrë të plotë, është e nevojshme të sigurohet një zgjidhje gjithëpërfshirëse softuerike, kështu që pas pëlqimit të Qeverisë së RMV për prokurim shumëvjeçar, me buxhetin për vitin 2021 dhe vitin 2022 u siguruan mjetet e nevojshme financiare për prokurimin e zgjidhjes së nevojshme softuerike. Procedura do të realizohet gjatë vitit 2021.

Për shkak të kushteve dhe rrethanave të cilat u përmendën më sipër, të dhënat mbi pasurinë e personave të zgjedhur dhe të emëruar ende dorëzohen në formatin e paraparë me zgjidhjet e vjetra ligjore. Noterët dhe përmbaruesit ende nuk paraqesin të dhëna për pasurinë dhe interesat e tyre, kryesisht për faktin se këtë obligim duhet ta kryejnë me formularin e ri, në përputhje me dispozitat kalimtare të LPKKI.

Gjatë vitit 2020, në KSHPK u dorëzuan gjithsej **1519** formularë të pasurisë, të paraqitura në Tabelën 9.

Tabela 9: Pasqyra e pyetësorëve të dorëzuar

Baza e dorëzimit të formularëve	viti 2020	viti 2019
Pyetësorët pas zgjedhjes/emërimit në funksion	607	1004
Pyetësorët pas përfundimit të detyrës	439	479
Formularë për ndryshime të pronës	473	524
Gjithsej	1519	2007

KSHPK në vazhdimësi përpunon pyetësorët e dorëzuar rishtas dhe azhurnon të dhënat për ndryshimet në pronë, ashtu që në faqen e tij të internetit (www.dksk.org.mk) në vitin 2020 u publikuan të dhënat nga pyetësorët për të gjithë 7491 personat e zgjedhur dhe të emëruar me mandat aktiv.

3.6. Kontrolli i të dhënave nga deklaratat e pasurisë dhe interesave

Komisioni Shtetëror është kompetent për të kontrolluar vërtetësinë e të dhënave nga Deklarata e pasurisë dhe interesave, në rastet kur shqyrton një lëndë specifike (neni 92 i LPKKI), si dhe në bazë të një plani vjetor për mbikëqyrjen e pasurisë dhe konfliktit të interesave (neni 19 i LPKKI). Në shkurt të vitit 2020, u miratua Plani Vjetor, i cili parashikonte verifikimin e të dhënave për pasurinë dhe konfliktin e interesave nga deklaratat e këtyre kategorive të zyrtarëve:

- Kryetarë të të gjithë gjykatave themelore në RMV;
- Kryetarë të të gjitha gjykatave të apelit në RMV dhe
- Prokurorë publikë të mëhershëm në Prokurorinë Publike për ndjekje të veprave penale të lidhura me përmbajtjet e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve dhe veprave që burojnë nga këto përgjime

Për realizimin e kontroleve të planifikuara, KSHPK ofron informata dhe të dhëna nga Agjencia për Kadastër të Patundshmërive, Ministria e Punëve të Brendshme, Depozituesi Qendror i Letrave me Vlerë, Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për më tepër, përveç nga Regjistri Qendror i RMV, në sistemin e shpërndarjes së të cilit KSHPK ka qasje të drejtpërdrejtë elektronike, të dhënat nga institucionet e tjera mblidhen në letër, gjë që komplikon dhe ngadalëson procesin e kontrollit të të dhënave nga pyetësorët e dorëzuar.

Tabela 10 tregon statusin për kontrollin e kryer të të dhënave për gjendjen pronësore në periudhën nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020.

Tabela 10: Pasqyra e kontrollit të kryer të të dhënave për pasurinë

Baza për veprim	viti 2020			viti 2019		
	Vetiniçiativë	Me parashtrresa	Gjithsej	Vetiniçiativë	Me parashtrresa	Gjithsej
Mosdorëzimi/Dorëzimit me vonesë i pyetësorëve / formularëve për ndryshim të gjendjes pronësore – neni 82 ose 85	35	12	47	60	39	99
Kontroll i të dhënave nga pyetësorët – neni 92	6	20	26	20	28	48
Plani vjetor për mbikëqyrjen e pasurisë dhe interesave për vitin 2020	42	/	42	73	-	73
Gjithsej:	83	32	115	153	67	220

Pas kontrollit të kryer administrativ të disa prej deklaratave të dorëzuara, KSHPK:

- ka lëshuar 73 urdhër-fletëpagesa për kundërvajtje, nga të cilat 60 i referohen mosdorëzimit ose dorëzimit të vonshëm të deklaratës, konform nenit 82 të LPKKI, dhe 13 urdhër-fletëpagesa për kundërvajtje, për mosraportimin e rritjes së pasurisë, konform nenin 85 të ligjit,
- Në të njëjtën periudhë, në Komisionin për Kundërvajtje të KSHPK u dorëzuan 16 kërkesa për fillimin e procedurave të kundërvajtjes, për shkak të gjobave të papaguara.

Për 42 raste KSHPK ka marrë vendime përfundimtare, ndërsa për rastet e mbetura, verifikimi i të dhënave është në zhvillim e sipër.

3.7. Regjistri i personave të zgjedhur dhe të emëruar

KSHPK mban Regjistër të personave të zgjedhur dhe të emëruar si një bazë e vetme të dhënash për personat e zgjedhur ose të emëruar, personin përgjegjës në një ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, noter, përmbarues, zyrtar administrativ i kategorisë A të përcaktuar me ligji ose person i punësuar në kabinetet e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Presidentit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Nënkyetarëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë, zëvendëskryeministrave, ministrave dhe Sekretarit të Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë; me qëllim të kryerjes së detyrave të këshilltarit të veçantë, gjatë përzgjedhjes, emërimit, caktimit, përkatësisht punësimit (neni 89 i LPKKI).

Regjistri azhurnohet çdo ditë me të dhënat e paraqitura në KSHPK nga persona të autorizuar të institucioneve që kanë kompetencën për të bërë zgjedhje dhe emërimë, brenda 15 ditëve nga zgjedhja, emërimi, gjegjësisht përfundimi i detyrës.

Që nga krijimi i regjstrit¹⁰ deri më 31 dhjetor të vitit 2020, janë shënuar të dhëna për 9,179 persona të zgjedhur dhe të emëruar, aktualë dhe të mëparshëm. Kjo nuk përfaqëson numrin e

¹⁰ Regjistri është në përdorim që nga viti 2016

saktë të personave të zgjedhur dhe të emëruar, për shkak të faktit se shumë institucione që kryejnë emërim dhe shkarkim, nuk përmbushin detyrimin për t'i raportuar KShPK. Për atë arsye, KSHPK nuk ka të dhëna reale dhe të sakta për numrin e personave të zgjedhur dhe të emëruar, nëse ata ende kryejnë aktivisht funksionin e tyre ose mandati i tyre ka mbaruar, nëse ka ndodhur rizgjedhje dhe të ngjashme.

Konsolidimi i Regjistrimit të personave të zgjedhur dhe të emëruar ka një rëndësi të madhe për KSHPK në drejtim të ushtrimit të kompetencave tjera në lidhje me regjistrimin dhe mbikëqyrjen e pasurisë dhe interesave, dhe kontrollimin e të dhënave nga deklaratat e interesave.

3.8. Zhvillimi i procedurave kundërvajtëse

Për shkeljet e dispozitave të LPKKI, gjegjësisht për mosveprim ose veprim jo në kohë të zyrtarëve, KSHPK ka mundësinë ligjore të ngrejë procedurë kundërvajtëse për të ndëshkuar një sjellje të tillë. Konform nenit 114 për shkeljet e vërtetuara të dispozitave të LPKKI, Komisioni për Kundërvajtje në KSHPK fillon procedurë kundërvajtëse dhe vendos sanksione kundërvajtëse. Komisioni për Kundërvajtje në KSHPK zgjidhet nga zyrtarët e autorizuar në Sekretariat, me nivel dhe profil përkatës arsimi dhe përvojë të nevojshme pune, nga të cilët të paktën një nga anëtarët është jurist i diplomuar me provim të dhënë jurisprudence.

Procedura kundërvajtëse zhvillohet në përputhje me Ligjin për kundërvajtje dhe para se të paraqitet kërkesë për fillimin e procedurës, aplikohet procedura e zgjidhjes me pagesë, me lëshimin e një urdhër-fletëpagese për kundërvajtje. Zyrtarët e autorizuar mbajnë evidencë për urdhër-fletëpagesat e lëshuara dhe rezultatin e procedurave të zhvilluara.

Tabela 11 tregon të dhënat për aktivitetet e Komisionit për Kundërvajtje në vitin 2020.

Tabela 11: Procedimet e Komisionit për Kundërvajtje në vitin 2020

Baza për procedurë kundërvajtëse	31.12.2020	31.12.2019
Mosdorëzimi/dorëzimi i vonuar i Deklaratës së pasurisë dhe mosraportimi i rritjes së pasurisë, nenet 82 dhe 85 të LPKKI	80	101
Dorëzimi i vonuar i dokumenteve të kërkuara; Kumulimi i funksioneve; Mosraportimi i konfliktit të interesit	16	16
Gjithsej urdhër-fletëpagesa të lëshuara	96	117
Gjoha të paguara	44	96
Procedura kundërvajtëse	22	14
- Sanksione të shqiptuara – gjoha	3	9
- Kërkesa të refuzuara	4	1
- Kërkesa të përsëritura për fillimin e procedurës për zgjidhje me pagesë	3	
- Ankesa të dorëzuara në komision të shkallës së dytë	3	6
- Në zhvillim e sipër	9	4
Pagesa të realizuara të gjobave në Buxhetin e RMV në denarë	472.005	937.840

Për shkak të mospagimit të gjobës së përcaktuar në urdhër-fletëpagesë, personat e autorizuar në KSHPK kanë dorëzuar 22 kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje për

një kundërvajtje të kryer. Pas kërkesave për fillimin e procedurave kundërvajtëse, deri më 31.12.2020, Komisioni për Kundërvajtje pranë KSHPK mori tre vendime për sanksion kundërvajës-gjobë, dy vendime që pezullojnë procedurën kundërvajtëse për shkak të tërheqjes së parashtruesit dhe dy vendime që refuzojnë kërkesën për iniciimin e një procedure kundërvajtjeje. Në tre raste, kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse u kthye në mënyrë që të zbatohet procedura për zgjidhje me pagesë, konform ligjit. Për lëndët tjera procedura është në proces.

Për shkeljet e përcaktuara të ligjit në përputhje me zgjidhjen e vjetër ligjore, me kërkesë të KShPK, procedura për kundërvajtje është zhvilluar nga një organ kompetent, përkatësisht Gjykata Themelore Shkupi 1 Shkup. Gjatë vitit 2020, Gjykata Themelore Shkupi 1 Shkup i ktheu Komisionit për Kundërvajtje të KSHPK dy çështje për rishqyrtim kompetent, të cilat gjykata nuk i shqyrtoi. Për lëndën e parë Komisioni për Kundërvajtje në KSHPK solli një vendim me të cilin kryesi lirohet nga përgjegjësia për shkak të vjetërsimit të krimit, ndërsa në lëndën tjetër kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse iu dorëzua KSHPK për të zbatuar procedurën e zgjidhjes me pagesë, konform LPKKI dhe Ligjit për kundërvajtje.

3.9. **Kontrolli i ligjeve dhe akteve nënligjore antikorrupsion**

Kontrolli i Legjislacionit Antikorrupsion (KLA), si një mekanizëm kryesor parandalues antikorrupsion, zbatohet në shumë vende. Kontrolli i legjislacionit antikorrupsion është një kompetencë e re e KSHPK e paraparë me LPKKI dhe e njohur si një masë e fuqishme parandaluese, edhe pse praktika për një kontroll të tillë ka filluar që nga viti 2016. Nga aspekti i kësaj kompetence të përcaktuar me ligj, KSHPK në një procedurë të veçantë, me angazhim, detyrim dhe ekspertizë të veçantë, shpreh mendimin e tij për të gjitha projektligjet që i dërgohen për mendim, me çka kontribuon në parandalimin në kohë të të gjitha pikave të cenueshme dhe rrezikut për korrupsion dhe konflikt të interesave në normat ligjore.

Rëndësia e KLA njihet dhe është përfshirë edhe në nenin 68 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë¹¹:

*“Ministritë dhe organet tjera të administratës shtetërore, materialet e dorëzuara Qeverisë për shqyrtim, përcaktim ose miratim, paraprakisht ua dorëzojnë për mendim organeve të administratës shtetërore kompetente, përkatëse dhe të interesuara dhe organeve të tjera shtetërore, në varësi të natyrës së materialit për shqyrtim, e **detyrimisht: ...Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit**, të gjithë projektligjet që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit legjislativ. **Materialet për të cilat nuk është marrë asnjë mendim, nuk do të merren parasysh në seancë të organeve punuese dhe Qeverisë**”.*

Metodologjia për kontrollin e legjislacionit antikorrupsion, në bashkëpunim me *Transparency International Maqedoni* u rishikua dhe u azhurnua gjatë vitit 2020. Qëllimi i Metodologjisë është të sigurojë zbatim të menjëhershëm, efikas dhe efektiv të kësaj kompetence përmes:

- definimit të procesit për kontroll të legjislacionit antikorrupsion dhe rezultatet nga procesi i realizimit;

¹¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.38/01, 98/02, 9/03, 47/03, 64/03, 67/03, 51/06, 5/07, 15/07, 26/07, 30/07, 58/07, 105/07, 116/07, 129/07, 157/07, 29/08, 51/08, 86/08, 114/08, 42/09, 62/09, 141/09, 162/09, 40/10, 83/10, 166/10, 172/10, 95/11, 151/11, 170/11, 67/13, 145/14, 62/15, 41/16 dhe 153/16)

- përcaktimit të fushëveprimit ose objektit të kontrollit antikorrupsion;
- definimit të rreziqeve për korrupsion dhe konflikt interesash;
- saktësimin të përmbajtjes së Raportit;
- organizimit dhe menaxhimit të procesit;
- definimit të rolit dhe përgjegjësisë të secilit pjesëmarrës në proces.

Në kuadër të projektit, *Transparency International Maqedoni* për dy persona nga Departamenti për Kontroll të Legjislacionit Antikorrupsion zhvilloi një trajnim në lidhje me zbatimin e Metodologjisë.

Duke pasur parasysh faktin se 2020 ishte një vit zgjedhor, e deri në gusht të vitit 2020 funksiononte qeveri teknike për zbatimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, deri në fund të vitit 2020 Qeveria e RMV nuk dha asnjë propozim-ligj për kontroll antikorrupsion, siç parashihet me Rregulloren e Punës.

Brenda kompetencave të saj, në bazë të kërkesave të dorëzuara, por edhe me vetiniciativë, KSHPK filloi me kontrollin antikorrupsion të ligjeve të mëposhtme:

- Ligji për tokë bujqësore;
- Rregullorja për mënyrën e funksionimit dhe përdorimit, karakteristikat hapësinore, tekniko-teknologjike dhe karakteristikat tjera të sistemit informatik mbikëqyrës, fushën dhe mënyrën e monitorimit të tij, si dhe mënyrën e lidhjes dhe shkëmbimit të të dhënave me sistemin informatik të Drejtorisë për të Ardhura Publike;
- Ligji për ndërtim;
- Ligji për automjete;
- Ligji për planifikim urban;
- Statuti i Odës të Stomatologëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut; dhe
- Ligji për ndërmarrje publike

Gjithashtu, që nga shkurti i vitit 2020, KSHPK është vazhdimisht e përfshirë dhe merr pjesë në grupin e punës, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në përgatitjen e ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin Zgjedhor.

3.10. Përvoja nga zbatimi i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave

Me Raportin Vjetor për funksionimin e KSHPK në vitin 2019, nxorrem në pah dobësi në disa dispozita të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, të cilat u imponuan si probleme thelbësore dhe në njëfarë mënyre punën e KShPK e bënë më të vështirë.

Gjatë vitit 2020, KSHPK u gjend në një situatë të palakmueshme në raport me zbatimin e dispozitave tjera të ligjit, disa prej të cilave i paraqesim në këtë Raport.

Mbikëqyrja e ligjshmërisë së financimit të partive politike

Neni 31

(1) Në rast të ekzistimit të dyshimit për financim të paligjshëm të një partie politike, Komisioni Shtetëror, me vetiniciativë ose me iniciativë të organeve shtetërore, partive politike ose shoqatave dhe fondacioneve që punojnë në fushën e parandalimit të korrupsionit, sundimit të ligjit ose qeverisjes së mirë, mund të **marrë vendim për të filluar procedurë për shqyrtim të financimit të partisë politike**.

(2) Komisioni Shtetëror ia **dorëzon iniciativën dhe vendimin** për fillimin e procedurës partisë politike së cilës i hetohet financimi, me thirrje për t'u deklaruar për pretendimet në këtë iniciativë, në afat prej 15 ditësh që nga dita e dorëzimit të saj partisë politike.

Obligimi i KSHPK për të marrë “Vendim” për fillimin e një procedure për shqyrtimin e financimit të partive politike, sipas praktikës së vendosur, paraqet një akt të procedurës administrative me të cilën personi juridik të cilit i drejtohet, ka të drejtën e këshillimit ligjor, ankesës ose në këtë rast, të drejtën e padisë në Gjykatën Administrative. Meqenëse nuk është ende e qartë nëse KSHPK është një organ i administratës shtetërore që gjatë ushtrimit të kompetencave të tij ligjore zbaton me përpikshmëri Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, një zgjidhje e këtillë ligjore që në fillim vë në dyshim çdo iniciativë për veprim të KSHPK, për shkak të mundësisë për anulim të vendimit të marrë.

Për të tejkaluar këtë situatë, është e nevojshme të rivedinohet mënyra në të cilën KSHPK do të fillojë një iniciativë të këtillë.

Ndalesa për përdorimin e huave dhe ndihmave tjera shtetërore

Neni 52

Personi juridik, themeluesi apo pronari i të cilit **ka qenë ose është** zgjedhur apo emëruar, ose themeluesi apo pronari i të cilit **është ose ka qenë** anëtar i familjes së tij ose në të cilin anëtar i familjes së tij është person përgjegjës ose në të cilin është zgjedhur apo emëruar, gjegjësisht anëtar i familjes së tij që posedon pjesë apo aksione, nuk mund të marrë grant, hua, respektivisht mbështetje financiare nga shteti ose njësi e vetëqeverisjes lokale.

Koha e foljes **“ishte”**, pa specifikuar periudhën minimale ose maksimale nga periudha kur personi i zgjedhur ose i caktuar ose anëtar i familjes së tij ka qenë themelues ose pronar i një personi juridik, praktikisht do të thotë që ai person juridik ASNJËHERË nuk mund të përdorë hua dhe lloje tjera të mbështetjes shtetërore, edhe 20 vite (v.a.) pasi që personi është zgjedhur ose emëruar.

Ky formulim krijon kushte të pabarazisë së personave juridikë për qasje në ndihmat shtetërore dhe për këtë shkak është e nevojshme të përcaktohen afatet brenda të cilave do të jetë i vlefshëm ky ndalim.

Neni 56

Një zyrtar **nuk guxon të ndikojë në punësimin ose ngritjen në detyrë të një personi të afërt në organin në të cilin ai është zgjedhur ose emëruar** ose në një organ tjetër shtetëror ose ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, të mbikëqyrur nga organi në të cilin është zgjedhur personi, gjegjësisht emëruar

Zgjidhja ligjore më sipër, si një “normë deklarative” është e qartë dhe koncize, por në praktikë është e vështirë të zbatohet sepse **“ndikimi”** nuk mund të vërtetohet, ndërsa është shumë e qartë se bëhet fjalë për **“keqpërdorim të së drejtës diskrete”** nga zyrtarët, që KSHPK e ka trajtuar si të tillë në vendimet e veta. Është shumë e qartë se të afërmit e personave të zgjedhur ose të emëruar nuk duhet të jenë “viktima” të pozitës së të afërmit të tyre dhe t’u kufizohet e drejta për punësim në një person juridik që disponon me kapital shtetëror, por ka edhe shumë raste të keqpërdorimit të funksionit pikërisht për shkak të punësimit të personave të afërt: personat përgjegjës, anëtarët e bordeve mbikëqyrëse dhe bordeve drejtuese punësojnë persona të afërt pikërisht në organin ku ata janë zgjedhur, duke përdorur normat ligjore: zyrtarisht nuk

merr pjesë në komisionin e përzgjedhjes për punësim, por ndikimi është i madh dhe nuk mund të vërtetohet lehtë.

Konsiderojmë se ka nevojë për një definim më të qartë të këtyre kushteve.

Paraqitja e pasurisë dhe interesave

Neni 82

Personi i zgjedhur ose i emëruar, personi përgjegjës në një ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, noter, përmbarues, zyrtar administrativ i kategorisë A të përcaktuar me ligj ose një person i punësuar në zyrat e Kryetarit të Republikës së Maqedonisë, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë, zëvendëskryeministrave të Republikës së Maqedonisë, ministrave dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me qëllim të kryerjes së detyrës *këshilltar special*, në zgjedhjen, emrimin, caktimin, përkatësisht punësimin, **jo më vonë se 30 ditë nga dita e zgjedhjes, emërimit, caktimit ose punësimin, dorëzon deklaratë pasurie dhe të interesave.**

KSHPK e ka për obligim të kontrollojë nëse personat e përzgjedhur kanë vepruar në përputhje me këtë nen dhe nëse konstaton dorëzim me vonesë ose mosdorëzim të Deklaratës së pasurisë dhe interesave, shqipton masa kundërvajtëse. Megjithëse zbatimi i kësaj dispozite është mjaft efikas, ekziston ende një situatë që duhet të tejkalohet.

Gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave zgjidhen nga Këshilli Gjyqësor i RMV, ndërsa prokurorët dhe kryetarët e prokurorive publike nga Këshilli i Prokurorëve Publikë të RMV, në procedura të parapara me ligj. Data e Aktit Zgjedhor, e miratuar nga këshilli përkatës nuk është një akt përfundimtar me të cilin gjyqtari, prokurori, kryetari i zgjedhur fillon angazhimin e tij të punës, por ai shtyhet për shkak të afateve për procedurat e apelimit që mund të jenë më shumë se 30 ditë nga zgjedhja e tyre. Në rast të anulimit të vendimit për zgjedhje, KSHPK përballet me mundësinë e fillimit të procedurave dhe vendosjen e një mase ndaj gjykatësit, prokurorit, kryetarit që mund edhe mos të emërohet.

Prandaj, është e nevojshme të përcaktohen afatet për dorëzimin e Deklaratës së pasurisë dhe interesave, sidomos për këtë kategori të personave të zgjedhur.

Neni 83

Bazuar në një vlerësim të rrezikut për korrupsion, **me një ligj që rregullon kryerjen e veprimtarisë në fushën e mbrojtjes, çështjeve të brendshme ose financiare**, personat me kompetenca të veçanta mund të detyrohen të dorëzojnë deklaratë pasurie dhe interesi.

Me këtë zgjidhje ligjore, dorëzimin e deklaratës së pasurisë dhe interesave nga personat me autorizime të veçanta brenda ligjeve të veta materiale, e kanë paraparë vetëm Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Doganave. Deklarata u dorëzohet institucioneve amë.

Në procesin e hartimit të Strategjisë Nacionale për luftë kundër korrupsionit, KSHPK gjithashtu përgatiti një Analizë të Rrezikut për Korrupsion, e cila konfirmoi se ekziston nevoja për

të përfshirë personat me kompetenca të veçanta, duke i detyruar ata të dorëzojnë Deklaratë të pasurisë dhe interesave:

- inspektorë në nivel lokal dhe shtetëror;
- zyrtarë që japin leje, licenca të ndryshme, si në institucione qendrore, ashtu edhe në ato lokale.

Zgjidhja ekzistuese ligjore, detyrimin për ta normativizuar me ligjet që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mbrojtjes, punët e brendshme ose financat, paraqet një pengesë të madhe për të përfshirë këta persona, duke pasur parasysh faktin se pakënaqësia më e madhe midis qytetarëve është për shkak të zbatimit jo të përpiktë dhe selektiv të ligjeve, për çka edhe nuk parashihen masa përkatëse ndëshkimore.

Për këtë arsye, KSHPK konsideron se është e nevojshme të bëhen ndryshime në këtë nen dhe në përputhje me Analizën e Rrezikut të Korrupsionit, të përfshihen fushat dhe kategoritë konkrete të zyrtarëve të cilët do të jenë të detyruar të paraqesin Deklaratën e pasurisë dhe interesave konform këtij ligji.

Karakteri publik i Deklaratës së pasurisë dhe interesave

Neni 87

- (1) Të dhënat nga deklarata e pasurisë dhe interesave dhe deklarata për ndryshim të gjendjes pronësore dhe interesave, paraqesin informata me karakter publik, përveç të dhënave të mbrojtura me ligj.
- (2) Të dhënat nga deklarata e pasurisë dhe interesave dhe deklaratat për ndryshim të gjendjes pronësore dhe interesave, që i dorëzohen Komisionit Shtetëror, përveç të dhënave të mbrojtura me ligj, publikohen në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror.

Zgjidhja aktuale ligjore nuk përcakton afatet për disponueshmërinë publike të të dhënave të deklaruara, ndërsa aplikacioni ekzistues elektronik i KSHPK siguron qasje në të dhëna gjatë mandatit aktual të një personi të zgjedhur ose të emëruar, dhe heqjen automatike të tyre pas përfundimit të mandatit.

Në përgjithësi të gjithë e dinë mënyrën e fshehjes së pronarit të vërtetë kur krijohet një pasuri gjatë një periudhe mandati aktiv të një personi të zgjedhur ose të emëruar, ashtu siç dihet edhe se pas një periudhe të caktuar nga përfundimi i mandatit, ndryshon gjendja pronësore. Legjislacioni, si dhe mungesa e një ligji të përgjithshëm mbi origjinën e pasurisë, i ndalon institucionet, përfshirë KSHPK, të ndërmarrin masat e duhura për të vërtetuar se ajo pasuri është fituar si rezultat i aktiviteteve korruptive ose keqpërdorimit të detyrës.

Për shkak të kësaj që u tha më sipër, ekziston nevoja për të definuar një periudhë kohore për publikimin e të dhënave nga Deklarata e pasurisë dhe interesave, që do të jetë më e gjatë se sa mandati i personave të zgjedhur dhe të emëruar, si dhe nevoja që KSHPK të ketë kompetencë ligjore për të inicuar procedurë për inspektimin e pronës edhe pas përfundimit të funksionit të tyre, por edhe të miratohet një Ligj për origjinën e pasurisë.

Dispozitat e numëruara dhe shpjegimet për problemet me të cilat përballet KSHPK në zbatimin e tyre, janë vetëm disa nga një grup dispozitash që janë identifikuar për shkak të pasaktësive ose mangësive që kanë dhe ndikojnë në efektivitetin e masave parandaluese dhe përpjekjeve për të parandaluar korrupsionin dhe konfliktin e interesave.

3.11. Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve – LMS

Me respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë, duke përmbyllur dispozitat e nenit 15 paragrafi (2) të Ligjit për sinjalizuesit¹², KSHPK, në kuadër të këtij raporti, për dy vite me radhë paraqet Raportin Vjetor për informata të pranuar nga sinjalizues në vitin 2020.

Me Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve (më tutje në tekst: LMS), u vendos një sistem mbrojtjeje me qëllim të nxitjes dhe inkurajimit të sinjalizimit, përkatësisht krijimin e një sistemi raportimi, gjegjësisht zbulimin e dyshimeve ose njohurive të arsyeshme se është kryer, po kryhet ose ka mundësi të kryhet një veprim i dënueshëm, joetik ose veprim tjetër i paligjshëm ose i palejueshëm që cenon ose rrezikon interesin publik.

Ky raport paraqet aktivitetet që ndërmarrin KSHPK dhe institucionet tjera të sektorit publik në lidhje me zbatimin e LMS dhe aktet nënligjore, që nga fillimi i zbatimit të LMS deri më 31 dhjetor 2020.

Norma ligjore

Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve u miratua më 9.11.2015 dhe filloi të zbatohet më 18.03.2016. Për zbatimin e tij, u miratuan akte nënligjore¹³, të cilat rregullojnë mënyrën e veprimit në lidhje me sinjalizimin e mbrojtur të brendshëm dhe të jashtëm në institucione nga sektori publik dhe privat. Zbatimi i akteve nënligjore që dalin prej tij, filloi së bashku me zbatimin e ligjit më 18.03.2016.

Veprimet e KSHPK në zbatimin e LMS

Duke vepruar në përputhje me kompetencat e përcaktuara në LMS dhe aktet nënligjore që dalin prej tij, KSHPK ndërmori aktivitete konkrete për krijimin e një sistemi të mbrojtjes së sinjalizuesve, kështu që duke filluar nga prilli i vitit 2016, u emërua një person i autorizuar për pranim të informatave të sinjalizuesve, për sinjalizim të mbrojtur të brendshëm dhe sinjalizim të mbrojtur të jashtëm, konform kushteve të parapara. Është miratuar një procedurë e brendshme për mënyrën dhe procedurën e pranimit të informatave nga sinjalizuesit, e cila është publikuar në faqen e internetit të KShPK.

Në periudhën nga zbatimi i LMS, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë dorëzuar raporte vjetore për informatat e pranuar nga sinjalizuesit për vitet 2016 dhe 2019, të publikuara në faqen e internetit të KSHPK. Në Kuvendin e RMV nuk janë dorëzuar raporte vjetore për vitet 2017 dhe 2018 për shkak të mosfunksionimit të KSHPK.

Regjistri i personave të autorizuar për pranimin e informatave nga sinjalizues

Me Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, në nenet 4 dhe 5, institucionet dhe personat juridikë nga sektori privat janë të detyruar të caktojnë persona të autorizuar për të pranuar informata nga

¹² Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.196/2015, 35/18

¹³ Rregullore për sinjalizim të mbrojtur të brendshëm në institucionet e sektorit publik, Rregullore për sinjalizim të mbrojtur të jashtëm dhe

Rregullore për udhëzime lidhur me miratimin e akteve interne për sinjalizim të mbrojtur të brendshëm në subjekt juridik të sektorit privat.

sinjalizues për sinjalizim të mbrojtur të brendshëm, të cilët janë të obliguar t'i dorëzojnë raporte KSHPK.

Neni 15 i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve:

“Të autorizuarit, përkatësisht udhëheqësit e institucioneve, gjegjësisht personat juridikë në sektorin publik të cilët paraqiten informata në përputhje me nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, janë të detyruar t'i paraqesin Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit raporte gjysmëvjetore për informata të pranuar nga sinjalizues.”

Duke filluar nga 18 marsi i vitit 2016, institucionet nga sektori publik dhe privat paraqesin pranë KSHPK njoftime për persona të autorizuar, të caktuar për pranimin e informatave nga sinjalizues në këto institucione. Në pajtim me detyrimet e parashikuara në nenin 17, paragrafi 1, pika 21 të LPKKI, e duke u bazuar në të dhëna të pranuar, KSHPK krijoi një Regjistër të personave të autorizuar për pranimin e informatave nga sinjalizues, i cili regjistër azhurnohet rregullisht. Tabela 12 tregon numrin e institucioneve që kanë vepruar në përputhje me LMS.

Tabela 12: Numri i institucioneve dhe personave të autorizuar sipas LMS

Viti	Numri i institucioneve*	Numri i institucioneve me persona të autorizuar	Numri i personave të autorizuar	Në %
Deri më 2019	1324	105	107	7,9%
2020	1324	113	115	8,5%

*- Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor për regjistrin e të punësuarve në sektorin publik për vitin 2019. Për vitin 2020 raporti akoma nuk është publikuar.

Megjithëse në vitin 2020 ka një rritje të lehtë të numrit të institucioneve që kanë caktuar persona të autorizuar për të pranuar informata nga sinjalizues krahasuar me vitin 2019 (në 2 institucione janë emëruar 2 persona të autorizuar), kjo tregon se zbatimi i LMS ende nuk është në nivel të kënaqshëm, dhe kjo kryesisht ndodh për shkak të mungesës së vullnetit politik për të vendosur një sistem efektiv të mbrojtjes së sinjalizuesve në institucionet e sektorit publik.

Inspektimi i faqeve të internet të institucioneve tregon se disa prej tyre kanë vepruar në përputhje me LMS dhe rregulloret, dhe kanë vendosur një sistem të sinjalizimit të mbrojtur të brendshëm¹⁴, por nuk kanë përmbushur detyrimin për të raportuar në KShPK.

Raportimi për informatat e pranuar nga sinjalizues

Institucionet në sektorin publik janë të obliguara të paraqesin raporte gjashtëmujore për pranimin e informatave nga sinjalizues, të cilat duhet të përmbajnë të dhëna të përgjithshme statistikore dhe të dhëna për lëndë të hapura pas sinjalizimeve të pranuar, konform nenit 15 të LMS. Megjithëse detyrimi për të paraqitur raporte gjashtëmujore nuk vlen për subjektet e sektorit privat, vihet re që një numër i tyre paraqesin raporte gjashtëmujore me vetiniciativë. Tabela 13 tregon numrin e raporteve të paraqitura në KSHPK, sipas viteve.

¹⁴ Është caktuar person i autorizuar për pranimin e informatave nga sinjalizues, janë publikuar të dhëna kontakti për personat e autorizuar për pranimin e informatave nga sinjalizues, janë publikuar procedura interne për sinjalizim të brendshëm të mbrojtur

Tabela 13: Raporte të dorëzuara gjashtë mujore në KShPK

Viti	Periudha	Institucione të sektorit publik	Persona juridikë në sektor privat	Gjithsej	Institucione që kanë pranuar sinjalizime	Sinjalizime të dorëzuara
2019	01.01-30.06	53	6	59	0	0
	01.07-31.12	57	11	68	0	0
2020	01.01-30.06	54	6	60	5	10
	01.07-31.12	66	7	73	3	11

Krahasimi i të dhënave për raportet e dorëzuara me të dhënat nga Regjistri, tregon se megjithëse shumica e institucioneve kanë krijuar një sistem të sinjalizimit të brendshëm të mbrojtur, ato nuk e kanë përmbushur detyrimin për të paraqitur një raport në KSHPK, sepse nuk kanë marrë informata nga sinjalizues.

Është karakteristike që, ashtu si vitin e kaluar, edhe në vitin 2020 Ministria e Punëve të Brendshme, prokuroritë përkatëse publike, Avokati i Popullit i RMV dhe institucione tjera kompetente, si institucione që kryejnë sinjalizim të mbrojtur të jashtëm, nuk e përmbushën detyrimin e tyre dhe nuk dorëzuan në KSHPK raporte gjashtë mujore për informatat e pranuar nga sinjalizues.

Kjo tregon se edhe organet të cilat janë të detyruara të kryejnë sinjalizim të mbrojtur të brendshëm dhe të jashtëm, nuk i përmbushin kompetencat e tyre të parapara me ligj, gjegjësisht institucionet nuk janë mjaft të përkushtuara në përmbushjen e detyrimeve të tyre të parashikuara me LMS.

Analiza e raporteve të pranuar gjashtë mujore

Në raportet e dorëzuara gjashtë mujore për gjysmën e parë të vitit 2020, pesë (5) institucione raportuan se personat e autorizuar në ato institucione pranuan gjithsej 10 informata nga sinjalizues, në bazë të të cilave janë ndërmarrë veprime dhe masa konform Ligjit për mbajtje të sinjalizuesve dhe akteve nënligjore.

Në gjysmën e dytë të vitit 2020, tre (3) institucione raportuan se pranuan 11 informata nga sinjalizues dhe se kanë vepruar në përputhje me ligjin.

Krahasuar me vitin 2019, kur asnjë institucion nuk raportoi se ka pranuar informata nga sinjalizues, të dhënat nga viti 2020 tregojnë se ka një përmirësim minimal në zbatimin e LMS për sa i përket sinjalizimit të mbrojtur të brendshëm. Duke u nisur nga fakti që ISHP njih dy kanale kryesore të sinjalizimit të mbrojtur, sinjalizimin e brendshëm të mbrojtur në të gjitha institucionet e sektorit publik dhe sinjalizimin e mbrojtur të jashtëm (MPB, zyra e prokurorit publik kompetent, KShPK, MPB, Avokati i Popullit), rritja e numrit të informatave përmes kanalit për sinjalizimin e brendshëm, tregon se qytetarët janë më të inkurajuar për të përdorur mundësinë e sinjalizimit të dyshimeve për paligjshmëri ose parregullsi në funksionimin e institucioneve publike, gjë që paraqet një hap të vogël para në zbatimin e LMS.

Institucionet që në kuadër të sinjalizimit të brendshëm pranuan raporte nga sinjalizues, kanë informuar se kanë vepruar në përputhje me ligjin, kanë ndërmarrë veprime specifike për të kontrolluar pretendimet e sinjalizimeve dhe kanë ndërmarrë masa konkrete konform ligjit.

Veprimet e KSHPK lidhur me informata të pranuar nga sinjalizues

Besimi i shtuar i opinionit publik në punën e KSHPK, ka kontribuar në rritjen e interesit të qytetarëve për mënyrën e sinjalizimit që garanton LMS.

Personi i autorizuar i KSHPK për pranimin e informatave nga sinjalizues, si dhe anëtarë tjerë të KSHPK, në mënyra të ndryshme përmes komunikimit të drejtpërdrejtë në takime, punëtori, konferenca ose deklarata në media, prezentuan në publik informata të shumta për mënyrën se si procedon KSHPK këto sinjalizime. Për herë të parë që nga miratimi i LMS, kjo rezultoi me lajmërimin e një numri të konsiderueshëm informatash nga sinjalizuesit, që pretendonin dyshime ose njohuri për sjellje të paligjshme ose të palejueshme në institucionet ku ata punojnë ose të cilat i kanë kuptuar në një mënyrë tjetër (duke kryer shërbime ose përmes një bashkëpunimi tjetër afarist). Sinjalizimi i shtuar në KSHPK është rezultat i frikës së bazuar për pasoja të dëmshme për sinjalizuesit ose të afërmit e tyre, që ata mund t'i pësojnë në raste sinjalizimi të brendshëm, si dhe për shkak të dyshimit se brenda institucioneve ku ata punojnë ankesat e tyre nuk do të shqyrtohen.

Përmbajtja e sinjalizimeve të pranuar

Informatat e sinjalizuara përmbajnë akuza me dyshime për veprime të paligjshme, të palejueshme dhe joetike nga persona përgjegjës ose nga zyrtarë tjerë në institucionet ku ata punojnë. Të gjitha informatat e dorëzuara nga sinjalizues në KSHPK përkasin në sinjalizimin e mbrojtur të jashtëm.

Forma dhe mënyra e pranimit të sinjalizimeve

Sipas Rregullores për sinjalizimin e mbrojtur të jashtëm në institucionet e sektorit publik, sinjalizuesi mund të përcjellë sinjalizim të mbrojtur të jashtëm, gojarisht në procesverbal ose me shkrim të një personi i autorizuar. Analiza e informatave të pranuar nga sinjalizuesit, tregoi se nga 6 raportet e përgjithshme të pranuar,

- tre sinjalizime me shkrim janë dorëzuar përmes postës dhe
- tre sinjalizime me shkrim, përmes postës elektronike, personit i autorizuar.

Të dhëna për anonimitet/konfidencialitet të sinjalizuesve

LMS e përkufizon sinjalizuesin si një person që me qëllim të mirë, përcjell një informatë të mbrojtur, por që nuk është i detyruar ta vërtetojë qëllimin e mirë dhe saktësinë e asaj që informon. Sinjalizuesi është i mbrojtur me ligj dhe ka konfidencialitet të garantuar.

Lidhur me të dhënat mbi anonimitetin ose konfidencialitetin, nga 6 informatat e pranuar, tre prej tyre janë dorëzuar nga sinjalizues konfidencial (identiteti i tyre dihet nga personi i autorizuar për pranimin e informatave nga sinjalizues), ndërsa tre informata janë dorëzuar nga sinjalizues anonim.

Kategoria e personave që janë bërë sinjalizues

Sipas kategorizimit të përkufizuar të personave që mund të paraqiten si sinjalizues, konform nenit 2 paragrafi (3) të LMS:

- 2 sinjalizues janë persona që janë në marrëdhënie pune në institucionin përkatës, gjegjësisht në subjektin juridik për të cilin informojnë;

- një sinjalizues ka qenë kandidat për punësim në institucionin ose subjektin juridik për të cilin ai/ajo informon dhe
- 3 sinjalizues që ishin anonimë dhe kategoria e tyre nuk mund të përcaktohet, në përputhje me nenin 2 paragrafi (3) të LMS.

Veprime të ndërmarra

Konform LMS, institucionet ku mund të kryhet sinjalizimi i mbrojtur i jashtëm, janë të detyruara që brenda kompetencave të tyre të shqyrtojnë informatën e pranuar, të mbrojnë të dhënat personale të sinjalizuesit, përkatësisht të dhënat që mund të zbulojnë identitetin e sinjalizuesit, i cili informon në mënyrë anonime ose konfidenciale, ndërsa për masat e ndërmarra të lajmërojnë sinjalizuesin pa vonesë, jo më vonë se 15 ditë nga data e pranimit të informatës.

Duke vepruar në përputhje me kompetencat e tij, personi i autorizuar për sinjalizim të jashtëm të mbrojtur në KShPK, hapi lëndë për të cilat vlerësoi përmbajtjen e sinjalizimeve veç e veç dhe solli konkluzat për kontrollimin e pretendimeve që ato përmbajnë, si dhe prezantoi konstatimet për gjendjen faktike. Prandaj, në institucione tjera dorëzoi gjithsej **10** kërkesa për:

- shqyrtim kompetent në institucione të ndryshme: për inspektim/kontrollim/mbikëqyrje të operacioneve financiare/zbatimin e rregulloreve ligjore në institucionin publik për të cilin është sinjalizuar;
- mbledhje të të dhënave dhe informatave në institucione të ndryshme: në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Agjencinë për Kadastrin e Patundshmërive, Qendrën Shtetërore të Provimeve, Inspektoratin Shtetëror të Punës, etj.

Për disa nga këto sinjalizime, ishte konstatuar se janë nën kompetenca të institucioneve tjera për sinjalizim të mbrojtur të jashtëm¹⁵, por për shkak se në to (përveç Ministrisë së Punëve të Brendshme) nuk janë krijuar sisteme funksionale për sinjalizim të mbrojtur të jashtëm, KSHPK duhej të veprojë për të verifikuar dyshimet e pretenduara.

Statusi i lëndëve dhe efektet nga procedimet

Tabela 14 tregon efektet e procedimeve të KSHPK në lidhje me lëndët e hapura, pas informatave nga sinjalizues, deri më 31 dhjetor të vitit 2020.

Tabela 14: Procedimet e KSHPK në bazë të informatave nga sinjalizues

Përshkrim i aktivitetit	Procedime në vitin 2020	Procedime në vitin 2019
Numri i sinjalizimeve të pranuar	6	19
Numri i sinjalizimeve për të cilat janë hapur lëndë	6	19
PROCEDIME TË KSHPK		
Sinjalizim i dorëzuar për shqyrtim në institucione tjera të sinjalizimit të mbrojtur të jashtëm, konform LMS	1	
Vendime të marra	17	
- Pretendime të pakonfirmuara	12	
- Nuk ka bazë ligjore për shqyrtim nga KSHPK	4	
- Me kërkesë të parashtruesit, lënda u dorëzua për shqyrtim të rregullt në KSHPK	1	
Shqyrtimi i KSHPK është në proces	5	

¹⁵ Neni 5 i LMS: Sinjalizuesi informimin e mbrojtur mund ta bëjë edhe në: MPB, prokurorinë publike përkatëse, KSHPK, te Avokati i Popullit ose institucione tjera kompetente apo subjekte juridike

INICIATIVA TË DORËZUARA		
➤	Inicativë e dorëzuar organit përkatës për konstatimin e përgjegjësisë së një zyrtari dhe Inicativë në PPRMV	1 1
	Sugjerime me udhëzime lidhur me masat dhe veprimet që duhet të ndërmerren ndaj një personi përgjegjës në institucion; shqyrtimi i lëndës nga KSHPK është në proces	1

➤ Shqyrtimi i një lënde prodhoi dy iniciativa

Në 12 raste, pasi kontrolloi pretendimet dhe konstatoi gjendjen faktike, KSHPK arriti në përfundimin se pretendimet nuk ishin konfirmuar dhe vendosi që nuk kishte elemente për procedimin e saj të mëtejshëm në formë të lëndëve konkrete, për ç'gjë u njoftuan edhe sinjalizuesit.

Pasi shqyrtoi lëndët dhe u njoh me përmbajtjen e sinjalizimeve, u konstatua se në dy raste KSHPK nuk ka kompetencë ligjore për të vepruar, sepse kompetente për të vepruar janë organe tjera, kështu që informatat iu përcollën Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për procedim të mëtejshëm kompetent.

Duke shqyrtuar një lëndë tjetër, KSHPK arriti në përfundim se nuk ka elementë për veprim kompetent për shkak të mungesës së bazës ligjore për sanksionimin e kryetarit të komunës, për shkelje të dispozitave të Ligjit për ndërmarrje publike dhe Ligjit për vetëqeverisje lokale, në lidhje me pretendimet në sinjalizim. Në drejtim të përmbushjes së rolit të tij parandalues, konform kompetencës së përcaktuar në nenin 17 paragrafi 1 pika 2 të LPKKI, KSHPK filloi kontrollin antikorrupsion të Ligjit për ndërmarrje publike, në mënyrë që të propozojë ndryshime dhe plotësime në ligj, me dispozita penale të cilat do të krijojnë bazë ligjore për sanksionimin e kryesve të veprave penale në raste mosveprimi ose veprimi në kundërshtim me dispozitat e këtyre ligjeve në të ardhmen.

Në një lëndë tjetër, KSHPK konfirmoi pretendimet e informatës së sinjalizuar, që pasoi me iniciativa të cilat iu dorëzuan Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për verifikimin e përgjegjësisë së personit të sinjalizuar dhe iniciativë për ndjekje penale në Prokurorinë Themelore Publike Shkup. KSHPK nuk ka pranuar informatë lidhur me procedimin e mëtejshëm të Prokurorisë Publike.

Pas përcaktimit se pretendimet në një sinjalizim kanë bazë, KSHPK personit udhëheqës në një ministri përkatëse që ishte subjekt i sinjalizimit të dorëzuar, i paraqiti një Sugjerim për të ndërmarrë masa dhe veprime konkrete për të kapërcyer situatën e krijuar që kishte konstatuar KShPK. Personi udhëheqës i ministrisë ndërmori një sërë veprimesh në drejtim të zgjidhjes së situatës dhe ende vazhdon.

Vendimet për këto lëndë janë publikuar në faqen e internetit të KShPK.

3.12. Shqyrtimi i kërkesave për qasje në informata me karakter publik

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, si një nga të drejtat themelore të Qytetarit nga korpusi i "lirive dhe të drejtave qytetare dhe politike", garanton qasje të lirë në informata, lirinë për të pranuar dhe për të transmetuar informata.

Duke u nisur nga parimi i karakterit publik të përfshirë në LPKKI, e duke pasur parasysh që publiku dhe modeli i funksionimit të hapur në punë janë në të mirë të transparencës së masave

dhe aktiviteteteve të ndërmarra nga KShPK, lëndët për qasje të lirë në informata me karakter publik trajtohen me një përkushtim të veçantë profesional.

Kështu, gjatë vitit 2020, në KShPK u dorëzuan 39 kërkesa për qasje në informata me karakter publik dhe ato u shqyrtuan brenda afatit të përcaktuar me ligj. Nga gjithsej 39 kërkesa për qasje në informata me karakter publik, 36 kërkesa morën përgjigje pozitive, ndërsa 3 kërkesa u refuzuan. Për kërkesat e refuzuara, parashtruesit nuk kanë bërë asnjë ankesë në agjencinë kompetente.

3.13. Zbatimi i rekomandimeve të GRECO-s nën kompetenca të KSHPK

Raundi i pestë i vlerësimeve të GRECO-s¹⁶ adreson parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit të pushtetit qendror (pozitat më të lartë ekzekutive) dhe agjencive të zbatimit të ligjit. Në Raportin për Maqedoninë e Veriut të miratuar në vitin 2019, jepen 23 rekomandime, të cilat më së shumti i referohen personave dhe institucioneve nga pushteti ekzekutiv dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjegjësisht Drejtorisë për Siguri Publike, por edhe për KShPK, ashtu si edhe në vlerësimet e mëparshme të GRECO-s, si institucion që duhet të sigurojë përmbushjen e rekomandimeve specifike.

Për të përmbushur Rekomandimin VI të Raportit - *“Rregullat për zbulimin dhe menaxhimin ad-hoc të konfliktit të interesave, duhet të plotësohen me udhëzime dhe masa praktike për zbatimin e tyre, siç janë trajnimi i dedikuar, këshillimi dhe ngritja e vetëdijes së personave që kryejnë funksionet më të larta ekzekutive”*, KShPK përpiloi një *“Udhëzues Praktik për rregullat për zbulimin dhe menaxhimin ad-hoc të konfliktit të interesave për anëtarët e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut”* dhe gjatë muajit dhjetor të vitit 2020, për anëtarët e Qeverisë zhvilloi trajnim *online* në formë punëtorie, në të cilën morën pjesë drejtorë dhe persona tjerë të emëruar nga Qeveria.

Gjithashtu, në mënyrë që të përmbushet Rekomandimin XIV (i) *“Rishikimi i Kodit Etik të policisë, në konsultim të gjerë me një spektër të madh të palëve të interesuara, përfshirë stafin policor në të gjitha nivelet, përfaqësuesit e tyre dhe shoqërinë civile, në mënyrë që të konsolidohen dispozitat dhe të ofrohen udhëzime gjithëpërfshirëse praktike mbi çështjet etike, duke përfshirë integritetin, konfliktin e interesit, dhuratat dhe parandalimin e korrupsionit”*, KShPK, në bashkëpunim me Departamentin e Kontrollit të Brendshëm, Hetimit Penal dhe Standardeve Profesionale, në nëntor të vitit 2020 zhvilloi trajnim për oficerë të lartë të policisë me temë *“Konflikti i interesave, integriteti dhe neutraliteti politik”*.

Angazhimi i KShPK është që këto trajnime dhe punëtori të mbahen vazhdimisht, në mënyrë që në kontinuitet të forcojnë vetëdijen për integritetin dhe sjelljen etike të personave të përfshirë në raundin e pestë të vlerësimit të GRECO-s.

¹⁶ Grup shtetesh për luftë kundër korrupsionit, i formuar në vitin 1999 nga Këshilli i Evropës

4. VLERËSIMI I GJENDJES SË KORRUPSIONIT DHE LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT NË VEND

Raportet, vlerësimet dhe hulumtimet e organizatave ndërkombëtare e vendore, organeve dhe komisioneve, paraqesin dokumente relevante për vlerësimin e situatës së korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në radhë të parë sigurisht është Raporti i Komisionit Evropian për progresin e RMV për vitin 2020, ku në përmbledhjen ekzekutive thuhet se Maqedonia e Veriut ka një nivel të caktuar të përgatitjes, respektivisht është mesatarisht e përgatitur. Edhe pse është arritur përparim i mirë në konsolidimin e historikut të hetimit, ndjekjes penale dhe ndëshkimit penal të çështjeve të korrupsionit në nivel të lartë, prapëseprapë korrupsioni është i përhapur në shumë fusha dhe kërkon një qasje më proaktive nga të gjithë faktorët e përfshirë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Raporti, në fushën e zhvillimit ekonomik dhe konkurrencës, tregon se ndikimi i korrupsionit në ekonomi mbetet një pengesë kryesore për kompanitë private në të bërit biznes dhe ndikon negativisht në prurjen e investimeve. Sa i përket prokurimeve publike, “vendi duhet të shtojë përpjekjet për të parandaluar parregullsitë dhe korrupsionin gjatë ciklit të prokurimit dhe për të siguruar një sistem më efikas të prokurimeve publike, duke ndjekur parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit”. Poashtu, “edhe sistemi arsimor është i ndjeshëm ndaj ndikimit politik dhe korrupsionit”.

Në pjesën e Raportit që i referohet Kapitullit XXIII - Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, theksohet se duhet të vazhdojnë përpjekjet për t'i dhënë fund korrupsionit në të gjitha nivelet.

Lidhur me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Raporti thekson se ai është veçanërisht proaktiv në parandalimin e korrupsionit dhe ka hapur një numër lëndësh, përfshirë ato që përfshijnë zyrtarë të lartë nga i gjithë spektri politik. Më tej thuhet se KSHPK vazhdon të trajtojë akuzat për nepotizëm, afërsi dhe ndikim politik në procesin e punësimeve në sektorin publik, por që autoritetet shtetërore duhet të sigurojnë që raportet dhe rekomandimet e tij të monitorohen në mënyrën e duhur.

Rekomandimet themelore të dhëna në Kapitullin XXIII sugjerojnë:

- “Të rritet numri i vendimeve përfundimtare në rastet e nivelit të lartë të korrupsionit, përfshirë edhe konfiskimin e mëtejshëm të pasurive kriminale” dhe
- “Të demonstron vullnet politik për të luftuar korrupsionin, duke mbështetur organet përkatëse me burime të vazhdueshme financiare dhe njerëzore dhe duke siguruar udhëzime të qarta të politikave për të gjitha institucionet shtetërore se si të trajtohet korrupsioni, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit” dhe
- “Prokuroria publike duhet të tregojë aftësinë e saj për të qenë proaktive në procedimin e lëndëve të dorëzuara nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Enti Shtetëror për Revizion dhe institucione tjera”.

Raporti për Maqedoninë e Veriut në kuadër të Raundit të Pestë të vlerësimit të GRECO-s që ka të bëjë me parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit në pushtetin qendror (funksionet kryesore ekzekutive) dhe organet e zbatimit të ligjit, i miratuar në mars të vitit 2019, përmban gjithsej 23 rekomandime, nga të cilat nëntë i referohen pushtetit ekzekutiv dhe 14 kanë të bëjnë me organet e zbatimit të ligjit, gjegjësisht Ministrinë e Punëve të Brendshme. Siç thuhet në Përmbledhjen Ekzekutive, “ky raport vlerëson efektivitetin e kornizës ligjore në Maqedoninë e Veriut për parandalimin e korrupsionit mes atyre të cilëve u janë besuar pozitativisht më të larta

ekzekutive (ministrat dhe sekretarët e shtetit, si dhe këshilltarët politikë) dhe forcat e policisë, si në Drejtorinë për Siguri Publike, ashtu edhe ato nën jurisdiksionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Korrupsioni konsiderohet si një problem serioz në Maqedoninë e Veriut. Raporti aktual synon të forcojë aftësinë e vendit për të luftuar korrupsionin, veçanërisht në drejtim të transparencës, integritetit dhe llogaridhënies së zyrtarëve publikë dhe institucioneve. Përgjigjet në lidhje me zbatimin e rekomandimeve iu dorëzuan GRECO-s gjatë dhjetorit të vitit 2020, ndërsa në mars të vitit 2021 GRECO do të miratojë raportin e parë të harmonizimit i cili do t'i paraqitet Qeverisë, kur edhe do të dihet se sa nga rekomandimet janë përmbushur plotësisht, pjesërisht apo nuk janë përmbushur aspak.

Indeksi i perceptimit të korrupsionit nga *Transparency International (TI)*, tregon se viteve të fundit Republika e Maqedonisë së Veriut ka ngecur në luftën kundër korrupsionit, por në të njëjtën kohë ka rënie edhe në rangimin e shteteve. Kështu, në raportin për vitin 2019, të cilin TI e publikoi në fillim të vitit 2020, Maqedonia e Veriut u rendit e 106-ta me 35 pikë indeksi, ndërsa në raportin për vitin 2020, të publikuar në janar të vitit 2021, vendi sërish arriti 35 pikë indeksi, por pësoi rënie në rangim dhe tani është në vendin e 111-të.

Rreziqet e korrupsionit të përmendura në raportet e mësipërme janë njohur dhe shpalosur në Strategjinë e rishikuar Nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të Interesave, për të cilat në Planin e Veprimit 2021-2025 janë propozuar masa dhe aktivitete të duhura për t'i kapërcyer ato.

E gjithë kjo tregon se **situata me korrupsionin është serioze** dhe nevojiten hapa të mëtejshëm për të forcuar kapacitetet materiale-teknike dhe njerëzore të institucioneve kompetente, pavarësinë dhe qasjen proaktive në funksionimin e tyre.

5. Aktivitete për përmirësimin e cilësisë së punës

5.1. Rregullore e Punës e KSHPK

Rregullorja e Punës është një dokument themelor që rregullon nga më afër mënyrën e punës dhe vendimmarrjen në KSHPK. Kjo rregullore është miratuar më 05.03.2019, dhe më pas në gusht të vitit 2019 ka pësuar ndryshime dhe plotësime.

Në qershor të vitit 2020, KSHPK ndryshoi Rregulloren e Punës, në mënyrë që të precizojë dhe avancojë më tej punën e KSHPK, veçanërisht në kushte urgjence dhe gjendjeje të jashtëzakonshme, dhe për të mbajtur seanca përmes video-konferencës.

Në korrik të vitit 2020, KSHPK përkufizoi një tekst të konsoliduar të Rregullores së Punës, që u publikua në faqen e internetit të KSHPK.

5.2. Plani strategjik për periudhën 2021-2023

Plani Strategjik i KSHPK është një dokument gjithëpërfshirës që përcakton qëllimet, masat dhe aktivitetet prioritare që duhen ndërmarrë, për të zbatuar dhe krijuar politikat e duhura për realizimin e tyre.

Forcimi i luftës së vendosur dhe joselektive kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave, si dhe forcimi i integritetit dhe pavarësisë së institucioneve drejt sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mire, është një prioritet që duhet të arrihet përmes zbatimit të Planit Strategjik në periudhën 2021-2023.

Ky prioriteti planifikohet të realizohet përmes përbushjes së Objektivave Strategjike në vijim:

- Përmirësimi i sistemit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit;
- Miratimi i vendimeve të bazuara dhe të zbatueshme të KSHPK;
- Përmirësimi i cilësisë së koordinimit dhe bashkëpunimit me organet e administratës shtetërore, institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile dhe
- Forcimi i kapacitetit institucional të KSHPK.

Me Planin Strategjik janë planifikuar mjetet për realizimin e programeve të sipërmendura: numrin e të punësuarve, burimet e nevojshme financiare, të shpërndara gjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023.

5.3. Strategjia për promovimin e sistemit për mbrojtje të sinjalizuesve

Me qëllim të informimit më të mirë të qytetarëve dhe të gjithë palëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe krijimin e një sistemi efikas dhe efektiv të sinjalizimit të mbrojtur dhe mbrojtjes së sinjalizuesve në vend, por edhe për të inkurajuar qytetarët të paraqesin sjellje të paligjshme, të palejueshme ose sjellje tjera të papranueshm/ duke u bazuar në praktikat dhe përvojat ndërkombëtare, në vitin 2017 filloi hartimi i një Strategjie për promovimin e sistemit të mbrojtjes së sinjalizuesve përmes *Projektit IPA 2012 "Forcimi i kapaciteteve nacionale për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit"*.

Si rezultat i këtij aktiviteti, në mars të vitit 2019, KSHPK miratoi “*Strategjinë për promovimin e sistemit të mbrojtjes së sinjalizuesve*”, e cila ka tre qëllime:

- realizimin e një fushate të ndërgjegjësimit publik, për të promovuar aspektet pozitive të sinjalizimit të mbrojtur dhe rolin e sinjalizuesve,
- zhvillimin dhe shpërndarjen e një pamfleti mbi praktikën, sistemet dhe procedurat më të mira për sinjalizimin e mbrojtur dhe
- realizimin e trajnimeve për target-grupe të ndryshme.

Megjithëse zbatimi i kësaj Strategjie pritej të realizohej në vitin 2020, realizim i një pjesë të madhe të aktiviteteve u shty për vitin 2021 për shkak të efekteve të pandemisë *Kovid-19*. Në vitin 2020, filluan të gjitha aktivitetet përgatitore për angazhimin e ekspertëve dhe formatin e ri të trajnimeve online, të cilat janë veçanërisht aktuale periudhën e fundit.

5.4. Krite të rangimit të lëndëve të cilët i shqyrton KSHPK

Duke u përballur me një numër të madh të kërkesave që qytetarët paraqitën si gjatë vitit 2019 (1172 parashtresa), ashtu edhe në vitin 2020 (550 parashtresa), KSHPK u gjend në një situatë që të humbë kohë duke shqyrtuar lëndë që janë nën jurisdiksion të organeve tjera ose po të cilat nuk përmbajnë elemente që aludojnë në sjellje korruptive ose keqpërdorim detyre. Duke marrë parasysh burimet e kufizuara që kishte në dispozicion (të punësuar, aplikacionet softuerike), por edhe rrezikun e trajtimit me vonesë të parashtresave me akuza të forta dhe të bazuara, KSHPK përgatiti një “Doracak për rangimin e lëndëve për shqyrtim nga KSHPK, në bazë të parashtresave të dorëzuara”.

Qëllimi i këtij doracaku është që përmes vlerësimit të kriteve të përcaktuara, në mënyrë objektive të bëhet përzgjedhja e parashtresave që do t’i shqyrtojë KSHPK, e që përmbajnë akuza mjaft të qarta dhe të qëndrueshme për praktika korruptive ose konflikt interesi të zyrtarëve, gjatë mandatit të tyre aktual. Doracaku do të përfshijë parashtresat e dorëzuara pas datës 01.01.2020 dhe është publikuar në faqen e internetit të KSHPK.

5.5. Transparenca në punën e KSHPK dhe informimi i opinionit publik

Informimi në kohë i publikut dhe transparenca në punë janë motoja themelore në funksionimin e KSHPK. Megjithëse seancat në të cilat KSHPK merr vendime brenda kompetencës së saj janë publike dhe mediat rregullisht marrin pjesë në to, KSHPK gjithmonë informon publikun në kohë për lëndët aktuale, situatat dhe aktivitetet.

Gjatë vitit 2020, KSHPK mbajti 60 takime dhe mbledhje me përfaqësues të institucioneve vendase, 40 takime me delegacione dhe organizata të huaja, në mënyrë që të forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe të ofrojë mbështetje për kapacitetet dhe aktivitetet e KSHPK. Presidenti dhe anëtarët e KSHPK morën pjesë në dy konferenca ndërkombëtare dhe katër konferenca me përfaqësues të vendit (të organizuara *online*), duke u përqëndruar në gjendjen e korrupsionit dhe aktivitetet për ta parandaluar atë.

Me qëllim të informimit të opinionit publik, u mbajtën tre konferenca për shtyp, Kryetari dhe anëtarët e KSHPK morën pjesë në 30 debate publike dhe emisione televizive. e u dhanë më shumë se 50 intervista.

6. Bashkëpunimi me institucione tjera dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, aktiviteti i të cilave është të mbështesin luftën kundër korrupsionit, filloi në vitin 2019 dhe vazhdoi me sukses gjatë vitit 2020. Mënyra e re e komunikimit *online* me partnerë nga organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet ndërkombëtare, të imponuara për shkak të ndjekjes së rekomandimeve për mbrojtje kundër pandemisë *Kovid-19*, nuk zvogëloi numrin e projekteve që gjatë vitit 2020 kanë prodhuar rezultate përfundimtare ose që filluan të zbatohen.

6.1. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile

Platforma e organizatave të shoqërisë civile për luftë kundër korrupsionit

Platforma e organizatave të shoqërisë civile për luftë kundër korrupsionit, e formuar nga 16 organizata të shoqërisë civile¹⁷, i dha kontribut dhe përkrahje të rezervë KSHPK, si në fazën e përgatitjes së Strategjisë Nacionale për parandalimin e korrupsionit 2021-2025, ashtu edhe në fazën e rishikimit të saj në periudhën nëntor-dhjetor të vitit 2020. Në lidhje me funksionimin e KSHPK, ajo siguroi mbështetje financiare nga burime të ndryshme, për projektet që u zbatuan në vitin 2020, si më poshtë:

Projekti: “Mbikëqyrje e suksesshmërisë së punës së KSHPK”

Realizimi i këtij projekti filloi gjatë vitit 2019 me qëllimin kryesor - mbikëqyrjen e aktiviteteve të KSHPK dhe analizimin e vendimeve të marra për lëndët e shqyrtua. Raporti u përgatit në bazë të një analize të dokumenteve që janë në dispozicion të publikut, në faqen e internetit të KSHPK dhe që është publikuar dhe në dispozicion të publikut edhe në faqen e internetit të Platformës së organizatave të shoqërisë civile për luftimin e korrupsionit¹⁸.

Si rezultat i aktiviteteve të implementuara me këtë projekt, gjatë vitit 2020 u publikuan raportet e mëposhtme:

- Raporti i parë për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për periudhën mars-shtator 2019;
- Raporti i dytë për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për periudhën tetor-dhjetor 2019;
- Studimi i politikave publike: Rritja e efikasitetit të KSHPK;
- Metodologjia dhe instrumentet e Komisionit antikorrupsion para zgjedhjeve;
- Hulumtimi: Problemet me financimin e partive politike;

¹⁷ Asociacioni për iniciativa demokratike, Instituti për demokraci Societas Civilis Shkup, Qendra për hulumtime të shoqërisë civile, Koalicioni për gjykim të drejtë, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, MOST, Metamorfozis, Instituti Ohri, Transparency International Maqedoni, *Transparencë* Maqedoni, Fondacioni *Shoqëri e Hapur* – Maqedoni, Forumi CSID, Qendra për komunikime civile, Qendra për hulumtim dhe krijimin e politikave, EVROTINK – Qendra për strategji evropiane, Komiteti i Helsinkit për të drejta të njeriut, SCOOP – Qendra për gazetari investigative

¹⁸ <http://antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1182&mv=4&fbclid=IwAR1NhsjGV2-HUfOt8xvOb8s-5Me40q5Lv2cFMYJCocEF3MrPo22eAOjg9s>

- Sfidat e llogaridhënies dhe integritetit të brendshëm të institucioneve me rrezik të lartë korrupsioni;

Në kuadër të të njëjtit projekt, në mbështetje të kompetencave ligjore të KSHPK, filloi kontrolli antikorrupsion për katër zgjidhje ligjore. Projekti vazhdon ende.

Instituti për demokraci Societas Civilis – Shkup IDSCS

Projekti: “Edukimi antikorrupsion i nxënësve në shkollat e mesme”

Projekti “Edukimi antikorrupsion i nxënësve të shkollave të mesme”, i filluar në vitin 2019, vazhdoi të zbatohet në vitin 2020. Projekti zbatohet në bashkëpunim me Institutin e shoqërisë civile për demokraci – IDSCS, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Entin për Zhvillimin e Arsimit.

Në gjysmën e parë të vitit 2020, u përgatitën doracakë për mësuesit dhe studentët, por gjithashtu u përgatit një fushatë edukative – fjalori antikorrupsion. Një pjesë e tij është botuar në faqen e internetit të KSHPK.

Në gjysmën e dytë të vitit 2020, në shkollat e mesme për lëndën Edukimi Qytetar, u përfshi edhe përmbajtja antikorrupsion.

Tranaprency Maqedoni – TM

Projekti: “Mbikëqyrja e punës, efektivitetit, transparencës dhe përgjegjësisë së KSHPK”

Në qershor të viti 2019, TM në bashkëpunim me Institutin për të Drejtat e Njeriut dhe mbështetjen e Ambasadës Britanike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, filloi projektin “Mbikëqyrja e punës, efektivitetit, transparencës dhe përgjegjësisë së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit”, ngjashmë me projektin më sipër. Projekti, i cili përfundoi në mars të vitit 2020, synonte që përmes analizave të kompetencave ligjore dhe mbikëqyrjes së punës dhe arritjeve të KSHPK, të jepte një vlerësim të efektivitetit dhe transparencës së tij, që më pas të dalin rekomandime për përmirësimin e situatës.

Në vitin 2019, në faqen e internetit të Transparency Maqedoni u publikuan dy raporte tremujore për mbikëqyrjen e punës së KSHPK, ndërsa në vitin 2020 edhe Raporti i Tretë tremujor për mbikëqyrjen e punës së KSHPK për periudhën dhjetor 2019-shkurt 2020, poashtu të publikuar në faqen e internetit të TM¹⁹.

Transparency International Maqedoni

Projekti: “Vlerësimi i fushave të rrezikshme dhe pikave të rrezikshme në deklarin e pasurisë”

Neni 19 paragrafi 1 i LPKKI parasheh që KSHPK të miratojë një plan vjetor për mbikëqyrjen e pasurive dhe konfliktit të interesave, bazuar në rreziqet e identifikuar për korrupsion të kategorive të caktuara të subjekteve dhe të ngjashme²⁰. Për përgatitjen e këtij plani vjetor dhe

¹⁹ http://www.transparentnost-mk.org.mk/sodrzina_detalno.aspx?id=305

²⁰ (1) Komisioni Shtetëror në tre muajt e fundit të viti aktual miraton plan vjetor për vitin e ardhshëm, për kontroll të financimit të partive politike dhe mbikëqyrjen e pasurisë dhe konfliktit të interesave, me qasje që bazohet në vlerësimin e rrezikut për korrupsion dhe që e detyron të marrë parasysh:

zgjedhjen e një mostre të bazuar në kritere objektive, me mbështetje financiare nga USAID, u sigurua ndihmë ekspertësh dhe për atë qëllim *Transparencë Maqedoni* përgatiti dhe dorëzoi në KSHPK “Metodologjinë për kontrollimin e pasurisë së gjykatësve”, bazuar në pikat e identifikuar të rrezikut gjatë deklarimit të pasurisë dhe zbulimit të mundësive për të fshehur pasurinë.

Kjo Metodologji duhet të shërbejë si bazë për zgjedhjen e gjykatësve që do të përfshihen me planet vjetore për verifikimin e deklaratave të pasurisë.

Projekti: “Cenueshmëria e legjislacionit në lidhje me korrupsionin, vlerësimi i praktikave dhe procedurave të punësimit me fokus të veçantë në nepotizëm, kronizëm dhe klientelizëm”.

Realizimi i këtij projekti filloi në shtator të vitit 2019, si një domosdoshmëri për të kapërcyer situatën me punësimet në sektorin publik, të cilat janë pasojë e procedurave të padefinuara mjaftueshëm, paqartësive ose mungesës së procedurave dhe të drejtave të mëdha diskrete në legjislacionin ekzistues. Pavarësisht kornizës ligjore, një numër i madh i lëndëve që shqyrtonte KSHPK, treguan ndikim të fortë partiak, nepotizëm, kronizëm dhe klientelizëm, veçanërisht në institucionet publike dhe ndërmarrjet aksionare të krijuara nga Qeveria e RMV, që flet mjaft për korrupsionin e ngulitur në vetë ligjet.

Kjo nxiti nevojën për të skanuar dhe analizuar kornizën ligjore (aktet ligjore dhe nënligjore) e cila rregullon procedurën për plotësimin e vendeve të lira të punës në sektorin publik, përmes procedurës së punësimit, procedurës së avancimit dhe procedurës për mobilitetin e të punësuarve në sektorin publik, në mënyrë që të vlerësohen llojet e rreziqeve dhe shkallën e korrupsionit në procedurat e punësimit në sektorin publik, për të identifikuar dobësitë dhe për të dhënë rekomandime për tejkalimin e dobësive të identifikuar.

Projekti u zbatua me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës dhe në tetor të vitit 2020 u publikua Raporti Përfundimtar: “Vlerësimi i cenueshmërisë së korrupsionit në politikën dhe procedurat e punësimit, me fokus të veçantë në nepotizëm, kronizëm dhe klientelizëm”.

Projekti analizoi 31 ligje, akte nënligjore, tre Raporte Vjetore nga Regjistri i të punësuarve publikë, u përgatit një Plan Veprimi me gjithsej 42 rekomandime përkatëse dhe 151 aktivitete të propozuara që do të ndërmerren për të ndryshuar ligje të caktuara, për të kapërcyer dobësitë e vërejtura në procedurat për punësim, avancim dhe mobilitet të stafit administrativ²¹. Raporti gjithashtu zhvilloi një Metodologji për mbikëqyrje tremujore të zbatimit të rekomandimeve. Raporti përfundimtar iu dorëzua Qeverisë së RMV dhe Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, si standarde (*bench marks*) të disa prej aktiviteteve të grupit punues për reformën e administratës publike.

Transparency International Maqedoni, me mbështetjen financiare të USAID CEP, për nevojat e KSHPK azhurnoi Metodologjinë për kontrollin e legjislacionit antikorrupsion dhe ofroi trajnime për të punësuarit lidhur me zbatimin e saj.

- të dhënat për rreziqet e identifikuar për korrupsion, në përputhje me analizën për rrezik korrupsioni konform nenit 17 paragrafi 1 pika 17 e këtij ligji,

- të dhënat për rrezikun e kategorive të veçanta të subjekteve, subjekteve të veçanta dhe të dhënave tjera në dispozicion për subjektet, e të tjera të ngjashme.

²¹ [https://dksk.mk/wp-](https://dksk.mk/wp-content/uploads/2020/12/%D0%A4%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BD-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98.pdf)

[content/uploads/2020/12/%D0%A4%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BD-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98.pdf](https://dksk.mk/wp-content/uploads/2020/12/%D0%A4%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BD-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98.pdf)

Bashkëpunimi i këtyre dhe aktiviteteve tjera në kuadër të projektit do të vazhdojë edhe në vitin 2021.

Asociacioni për iniciativë demokratike dhe Koalicioni i shoqatave qytetare “Të gjithë për gjykim të drejtë”

Projekti: Mbikëqyrja dhe përmirësimi i kapacitetit të institucioneve për t'u përballur me krimin e organizuar dhe korrupsionin

Projekti që filloi të zbatohet në shkurt të vitit 2019 me qëllim të përmirësimit të punës së institucioneve, me mandat për të luftuar krimin e organizuar dhe afat realizimi prej 30 muajsh, synon arritjen e qëllimeve specifike të projektit:

- përmirësimin e transparencës së Prokurorisë Speciale Publike (PSP), Prokurorisë Themelore Publike lidhur me ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) dhe
- vlerësimin e efikasitetit të Gjykatës Themelore Shkup 1, në trajtimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe rritjen e besimit të publikut në institucionet që kanë mandatin për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Në kuadër të projektit, për periudhën janar-qershor 2020, u publikua raporti: *Transparenca e institucioneve për parandalimin e korrupsionit gjatë një pandemie: Sa e rëndësishme është lufta kundër korrupsionit në një gjendje të jashtëzakonshme*”.

6.2. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare

Mbështetja për KSHPK nga bashkësia ndërkombëtare nuk mungoi, kështu që gjatë vitit 2020, me mbështetje të drejtpërdrejtë, filloi realizimi i shumë aktiviteteve, të cilat përmbushin disa kompetenca të rëndësishme të KSHPK.

USAID – NMSI

Bashkëpunimi me USAID vazhdoi edhe në vitin 2020 përmes realizimit të projektit NMSI me qëllim zhvillimin e kapaciteteve komunikuese të KSHPK. Ky aktivitet u përqendrua tek anëtarët e KSHPK, e për këtë qëllim u përgatitën dhe u publikuan disa dokumente:

- Vlerësimi i gjendjes së KSHPK dhe Analizë e qëndrimeve për gazetarë të përzgjedhur
- Strategji komunikimi
- Krijimi i sistemit të komunikimeve dhe definim i procedurave
- Politikë për marrëdhënie me mediat dhe Politikë për komunikim të rrjeteve sociale
- Plani për komunikim në rrjete sociale
- Përzgjedhja e logos dhe sloganit
- Krijimi i profileve në rrjete sociale
- Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve, me përgatitje të një doracaku
- Përgatitja e raporteve ditore të monitorimit të mediave
- Përgatitje e raporteve ditore të mediave të shtypura dhe konsulencë komunikimi, sipas nevojës
- Disenjë dhe prodhim i elementëve për brendim dhe libër për standardet grafike

Këshilli i Evropës

Në kuadër të bashkëpunimit të vendosur me projektin kundër krimit ekonomik, i cili zbatohet nga Këshilli i Evropës në kuadër të Programit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, në gjysmën e parë të vitit 2020 u realizua një seminar lidhur me temën: “Vlerësimi i kapaciteteve të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në financimin e partive politike”. Bashkëpunimi me Këshillin e Evropës do të vazhdojë në përputhje me planin e vendosur të veprimit. Në punëtorinë e mbajtur në fillim të marsit të vitit 2020, përveç përfaqësuesve të KSHPK, morën pjesë përfaqësues të KSHZ, ESHR dhe ASHMAA, si institucione që në një farë mënyre mbikëqyrin partitë politike, si punën e tyre të rregullt, ashtu edhe aktivitetet e tyre gjatë procesit zgjedhor. Nga ky seminar, për nevojat e KSHPK, dolën dy dokumente: “Metodologjia për kryerjen e kontrollit/monitorimit të aktiviteve në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore” dhe “Udhëzimet dhe procedurat e brendshme për mbikëqyrjen e financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit”.

Iniciativa Rajonale Antikorrupsion

Në shtator të vitit 2020, Sekretariati Rajonal për luftë kundër korrupsionit (Sekretariati RAI) dhe KSHPK nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi në mënyrë që të përmirësojnë kanalet e raportimit të sinjalizuesve dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre, duke zbatuar aktivitetet e parashikuara në kuadër të projektit të financuar nga BE “Thyerja e heshtjes: Promovimi i politikave dhe kulturës së sinjalizimit në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Moldavi” (me tutje në tekst: Projekti), i zbatuar nga Sekretariati RAI.

Qëllimi përfundimtar i nënshkrimit të Memorandumit është forcimi i kanaleve për zbulimin e informatave dhe mekanizmave të mbrojtjes në kuadër të kompetencave të KSHPK, që është thelbësore për të inkurajuar sinjalizimin si një mjet efektiv për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e korrupsionit.

Misioni i OSBE në Shkup

Bashkëpunimi afatgjatë me Misionin e OSBE në Shkup vazhdoi edhe në vitin 2020, me nënshkrimin e Memorandumit për Mirëkuptim ndërmjet OSBE dhe KSHPK, për realizimin e aktiviteve të përbashkëta në periudhën 2020-2022. Me këtë dokument u arrit marrëveshja që OSBE të sigurojë mbështetje strategjike për KSHPK në përpjekjet e saj për të zbatuar aktivitete në fushën e parandalimit të korrupsionit dhe forcimin e integritetit personal dhe institucional, veçanërisht në nivel lokal dhe në përputhje me standardet nacionale, angazhimet e OSBE dhe standardet ndërkombëtare.

Në vitin 2020, në kuadër të projektit u përgatitën “Politika e integritetit në nivelin lokal” dhe “Udhëzimet për zbatimin e politikës së integritetit në njësitë e vetëqeverisjes lokale”.

Projekti: IPA II – Mbështetje reformës së administratës publike.

Mbështetja dhënë KSHPK përmes këtij projekti, përqëndrohet në gjashtë (6) fusha:

- Forcimi i kapaciteteve të KSHPK përmes trajnimeve dhe përmirësimit të përbërjes organizative, për përmbushje më të mirë të kompetencave të saj dhe zhvillimin e mjeteve informatike të duhura për përmirësimin e komunikimit dhe matjen e performancës, transparencës dhe llogaridhënies së KSHPK;
- Promovimi i konceptit të integritetit dhe zbatimi i tij në nivelin politik dhe profesional, përfshirë zhvillimin e veglave informatike të duhura për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave;
- Mbështetje në zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe ngritjen e vetëdijes për kontekstin pozitiv të mbrojtjes së sinjalizuesve;
- Mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e fushatave antikorrupsion, ngritjen e vetëdijes brenda administratës publike, komunitetit të biznesit, ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërisë civile, në lidhje me rëndësinë e sjelljes etike dhe integritetit, si dhe mjetet në dispozicion për të parandaluar korrupsionin dhe konfliktin e interesave;
- Azhurnimi dhe ndërlidhja e zbatimit të platformës për e-mësim me Sistemin e Menaxhimit të Mësimin (LMS) në kuadër të MSHIA dhe zhvillimi i mësimëve mbi integritetin, mbrojtjen nga të pavërtetat, etika, korrupsioni dhe konflikte interesi, me qasjen e duhur metodologjike dhe përmbajtje audio-vizuale për grupe të ndryshme të synuara dhe
- Mbështetje në procesin e Strategjisë Nacionale për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit dhe konflikteve të interesit në zhvillimin e një vegle informatike për mbikëqyrjen e tij.
- Aktivitet shtesë që do të sigurohet përmes projektit është zhvillimi i një zgjidhjeje softuerike për kontrollin e legjislacionit antikorrupsion.

Periudha e zbatimit të projektit është 24 muaj.

Duke pasur parasysh situatën aktuale me pandeminë, shumë prej aktiviteteve të planifikuara për zbatim në vitin e parë janë prolonguar.

IPA – Reorganizimi i administratës shtetërore Komponenti 2 – Përmirësimi i kornizës së të drejtave diskrete

Në fund të vitit 2020, në kuadër të projektit IPA - Mbështetje për Riorganizim Shtetëror, filloi zbatimi i Komponentit 2 - Përmirësimi i kornizës së të drejtave diskrete, i cili synon të optimizojë kornizën e përgjithshme institucionale, të përmirësojë punën e shërbimeve publike dhe të forcojë etikën, integritetin, transparencën dhe llogaridhënien e administratës publike. Projekti duhet të sigurojë një analizë të:

- kornizës ligjore që rregullon dhënien e llojeve të ndryshme të lejeve dhe licencave që kanë ndikim në mjedis;
- legjislacionit që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë individuale të qytetarëve (taksat, të drejtat e pronës)
- legjislacionit që mbulon punësimin në fusha specifike.

Periudha e realizimit të këtij projekti është 30 muaj.

7. Buxheti, bilanci vjetor dhe financimi

Mjetet për funksionimin e KSHPK sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes llogarisë buxhetore 020036004663719, që funksionon si përdorues i buxhetit të linjës së pare, përmes Thesarit të Ministrisë së Financave,.

Tabela 15 tregon fondet e planifikuara nga Buxheti i RMV për nevojat e KSHPK gjatë viteve 2019 dhe 2020.

Tabela 15: Buxheti i KSHPK

Zërat	2020			2019		
	Buxheti	Realizimi	Realizimi i buxhetit në %	Buxheti	Realizimi	Realizimi i buxhetit në %
40-Rroga dhe kompensime	25,461,000	24,771,136	97.3	22,263,000	21,703,341	97.5
42-Mallra dhe shërbime	7,770,000	6,120,513	78.8	12,000,000	5,142,837	42.9
46-Transfere	18,000	15,000	83.3	110,000	30,516	27.7
48-Shpenzime kapitale	500,000	237,102	47.4	1,230,000	0	0.0
Gjithsej:	33,749,000	31,143,751	92,3	35,603,000	26,876,694	75,5

Shuma e zvogëluar e mjeteve të planifikuara në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, është për shkak të pasojave të krizës *Kovid-19*, rialokimit të mjeteve të përdorues tjerë me Rebalancin e buxhetit për vitin 2020, si dhe kufizimit të prokurimeve.

Tabela 16 tregon shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2020 sipas qëllimeve dhe shpenzimet individuale nga zërat e shpenzimeve

Tabela 16: Shpenzime të planifikuara dhe të realizuara në KSHPK

Shpenzime	2020		2019	
	Buxheti	Realizimi	Buxheti	Realizimi
Rroga bazë	18,451,000	17,791,763	16,113,000	15,722,861
Kontribute për sigurim social	7,010,000	6,979,373	6,150,000	5,980,480
Shpenzime rruge dhe shpenzime ditore	800,000	680,543	2,500,000	595,351
Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	2,270,000	2,159,578	2,400,000	1,747,274
Materiale dhe inventar i imët	940,000	446,375	900,000	313,587
Riparime dhe mirëmbatje	800,000	405,947	500,000	51,260
Shërbime të kontraktuara	2,400,000	2,386,808	4,800,000	1,877,894

RAPORTI VJETOR PËR PUNËN E KSHPK PËR VITIN 2020

Shpenzime tjera rrjedhëse	560,000	41,262	900,000	557,471
Transfere të ndryshme	18,000	15,000	110,000	30,516
Blerje të pajisjeve dhe makinave	0	0	500,000	0
Objekte ndërtimi	0	0	300,000	0
Objekte tjera ndërtimi	400,000	211,496	30,000	0
Mobilje	0	0	100,000	0
Investime dhe mjete jofinanciare	100,000	25,606	300,000	0
GJITHSEJ:	33,749,000	31,143,751	35,603,000	26,876,694

Shumica e mjeteve të planifikuara kanë për qëllim pagimin e rrogave, tatimeve dhe kontributeve të rrogave për 24 nëpunës civilë (nga tetori i vitit 2020 – 23 të punësuar) dhe shtatë anëtarë të zgjedhur të komisionit.

Shumica e fondeve janë shpenzuar për funksionimin e përditshëm të Komisionit, gjegjësisht për pagimin e: shpenzimeve të udhëtimit për anëtarët e Komisionit, shërbimeve komunale, ngrohjes, komunikimin dhe transportit, postës, telefonit, internetit, shërbimeve për përkthimin e materialeve, kopjim, printim dhe botim, sigurimit të pasurive të patundshme, punësimit të dy personave të jashtëm për të mirëmbajtur pajisjet dhe softuerin në dispozicion të KSHPK, angazhimit të dy personave të jashtëm për ekspertizë të jashtme, në përputhje me nenin 28 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesit, dhe të ngjashme.

Në janar të vitit 2020, u miratua plani për prokurime publike, i cili gjatë vitit 2020 pësoi tre ndryshime për shkak të zvogëlimit të mjeteve si rezultat i efekteve të krizës *Kovid-19*, por edhe për shkak të nevojës për rikonstruimin e mjediseve që shfrytëzon KSHPK. Nga 23 prokurime të planifikuara, gjatë vitit 2020 janë realizuar njëmbëdhjetë procedura, në vlerë të përgjithshme prej 2,080,563 denarë përfshirë TVSH-në, ndërsa për dymbëdhjetë prokurimet e mbetura nuk u lidhën marrëveshje.

Nevoja për rialokimin e mjeteve në Buxhetin e RMV për t'u përballur me efektet e krizës *Kovid-19*, vuri në dyshim blerjen e hapësirave të planifikuara për KSHPK, kështu që KSHPK vendosi të përmirësojë kushtet me rikonstruktiv të hapësirave ekzistuese, në mënyrë që përfundimisht të mund të vendosen në funksion pajisjet që KSHPK i ka në dispozicion përmes projekteve IPA nga 2018. Prokurimi për rikonstruktiv të hapësirave ka filluar dy herë gjatë vitit 2020, por akoma nuk është kontraktuar marrëveshje për realizimin e rikonstruktiv. Në fillim të vitit 2021, Qeveria e RMV gjeti një zgjidhje për problemet e KSHPK me hapësirat dhe kjo zgjidhje do të realizohet gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2020, KSHPK pranoi një donacion me mobilje zyre, që në Bilancin Vjetor për vitin 2020 paraqitet si rritje në zërin përkatës.

Pajisjet kompjuterike, të cilat u siguruan përmes fondeve IPA të Bashkimit Evropian për nevojat e KSHPK dhe që duhej të ishin në funksion deri në dhjetor të vitit 2019, akoma nuk janë plotësisht në përdorim. Kjo është kryesisht për shkak të kushteve të pazgjidhura me zyrat, kështu që serverët janë akoma të vendosur në Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa pjesa tjetër e pajisjeve, megjithëse janë marrë dhe vendosur në mjediset e KSHPK, nuk janë plotësisht funksionale. Qeveria e RMV, me buxhetin për vitin 2021, siguroi fonde për prokurim shumëvjeçar të zgjidhjes softuerike për dorëzimin elektronik të deklarimit të pasurisë dhe interesave, publikimin e tyre,

sistemin e mbledhjes së të dhënave nga institucionet tjera, përpunimin e tyre, modulën e menaxhimit të dokumenteve dhe mirëmbajtjen e të gjithë sistemit, për realizimin e të cilit në proces është prokurimi publik për përzgjedhjen e operatorit ekonomik më të favorshëm.

8. PËRFUNDIMET

Viti 2020 do të mbahet mend si viti i pandemisë *Covid-19* dhe viti i mbrojtjes së shëndetit publik si një qëllim prioritar në të gjithë botën. Në atë drejtim, Qeveria e RMV përshkroi kushte të veçanta pune dhe masa kufizuese për punë dhe lëvizje, të cilat ndryshuan shumë mënyrën e punës së rregullt të të gjitha subjekteve, si private ashtu edhe ato publike, përfshirë KSHPK.

Në vitin 2020, gjetjet konfirmuan për dobësi të shumta në ligje dhe keqpërdorimin e tyre, veçanërisht në punësimet në sektorin publik mbi parimin e ndikimit (partiak, farefisnor, miqësor), keqpërdorimin e funksioneve dhe kompetencave në dhënien e lejeve dhe kontratave të ndryshme, duke krijuar kushte për të favorizuar kompani dhe ngjashëm.

Për të përmirësuar punën e tij, KSHPK miratoi akte të reja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariat, zhvilloi një aplikacion dhe kriteret për prioritetizimin e lëndëve, ndryshoi Rregulloren e Punës dhe mundësoi zhvillimin online të seancave dhe kolegjiuemeve, si dhe punën nga distanca për të punësuarit.

Pavarësisht problemeve që janë ndjerë në të gjithë vendin si rezultat i krizës *Kovid-19*, KSHPK vazhdoi të përballet me problemet e vjetra dhe të reja në funksionimin e tij, si më poshtë:

1. Personeli i pamjaftueshëm, zbatimi i masave të mbrojtjes nga virusi Corona për punën në ndërrime, mungesat për shkak të infeksionit viral ose izolimit të karantinës, kanë zvogëluar fushëveprimin dhe trajtimin e rasteve dhe projekteve të filluara;
2. Edhe në vitin 2020 nuk u zgjodh problemi i sigurimit të hapësirës dhe mjeteve financiare për zhvillimin e një zgjidhjeje softuerike për qasje në bazat e të dhënave të 17 institucioneve tjera, as për dorëzimin elektronik të Deklaratës së pasurisë dhe interesave;
3. U identifikuan edhe dispozita tjera të LPKKI, të cilat shkaktuan dilema gjatë shqyrtimit të lëndëve për shkak të pasaktësisë dhe paqartësisë së tyre;
4. Mosmiratimi i Strategjisë Nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nga Kuvendi i RMV vonoi veprimet e institucioneve në zbatimin në kohë të masave dhe aktiviteteve të planifikuara me Planin e Veprimit dhe pamundësoi kompetencën ligjore të KSHPK për të mbikëqyrur zbatimin e Strategjisë Nacionale.

Anëtarët e KSHPK vlerësojnë se gjatë vitit 2020, përkundër të gjitha sfidave, si në nivelin shtetëror ashtu edhe në atë institucional, Komisioni Shtetëror vazhdoi të kryejë përgjegjësitë e tij në mënyrë efikase, brenda kapaciteteve në dispozicion.

9. REKOMANDIME

Për të përmirësuar funksionimin e përgjithshëm dhe për të rritur efektet e punës së KSHPK, është e nevojshme që në periudhat e ardhshme të merren masa dhe aktivitete të caktuara që do të kontribuojnë në funksionimin më të mirë të tij. Zbatimi i masave dhe aktiviteteve konkrete është një detyrë jo vetëm për KSHPK, por edhe për institucionet tjera. Në këtë kontekst, ne japim rekomandimet e mëposhtme:

KSHPK

Të realizojë prokurimin e një zgjidhjeje softuerike për qasjen në bazat e të dhënave në 17 institucione tjera dhe dorëzimin elektronik të Deklaratës së pasurisë dhe interesave.

Ministria e Drejtësisë

Duke u bazuar në dobësitë e identifikuara të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (pika 3.9. në këtë Raport), të iniciohen ndryshime dhe plotësime të ligjit, për të kapërcyer dobësitë e identifikuara.

10. SHTOJCA

Iniciativa për fillim të procedurës për ndjekje penale lidhur me lëndët nga fusha e korrupsionit	Shtojca 1
Iniciativat para organeve kompetente për fillimin e procedimeve për verifikimin e përgjegjësisë së zyrtarëve	Shtojca 2
Iniciativat e dorëzuara për përgjegjësinë dhe shkarkimin e zyrtarëve, për shkak ekzistimit të konfliktit të interesave	Shtojca 3
Bilanci Vjetor për vitin 2020	Shtojca 4